-  Gjatë vitit 2015, DAB ka realizuar 22 auditime të plota nga 31 të planifikuara, është realizuar 1(një) auditim i përputhshmërisë nga 1(një) i planifikuar, janë realizuar 6 auditime për zbatimin e rekomandimeve nga 6 te planifikuara, si dhe ka kryer 19 auditime të pa planifikuara, me kërkesë të “Menaxhimit të Lartë” në 19 institucione.
 -  I është dhënë prioritet: auditimeve në subjektet që kanë patur një kohë të gjatë pa u audituar, procedurave të prokurimit, auditimeve në fushën e pagave dhe të shpërblimeve, sistemit të burimeve njerëzore në DAR/ZA.
 -  Programet e auditimit janë përmirësuar vazhdimisht, duke hartuar programe me kërkesa analitike, drejtë standardeve të auditimit.
 -  Gjatë vitit 2015, vlera e gjetjeve gjithsej është 201.864.000 lekë, nga këto: Tarifë shkollimi e pa arkëtuar 200.587.000 lekë, mosarkëtime nga qiratë 183.000 lekë, paguar më shumë për orë shtesë 50.000 lekë, pagesë për lejet vjetore në kundërshtim me aktet ligjore 23.000 lekë, pagesë për sportistët në kundërshtim me aktet ligjore 171.000 lekë, pagesë për grumbullimin e sportistëve në kundërshtim me aktet ligjore 850.000 lekë.
- **Gjetjet me risk të lartë**, për vitin 2015 si gjetje me risk të janë klasifikuar, Tarifat e shkollimit në universitete, zbatimi i normave të ngarkesave për mësuesit dhe niveli i formimit, normat e ngarkesave për pedagogët
 - DAB, ka dhënë rekomandime, për të gjithë sistemin e MAS-it, si më poshtë:
 - a) **Rekomandime të prioritetit të lartë:**Përpilimi i kuadrit rregullator për funksionimin e Institucionit; Rakordomi i institucioni me Arsimin profesionalë për botimin e shpërndarjen e teksteve; Rishikimi i sistemit të kontrollit të brendshëm për monitorimin e ngarkesës mësimore; Zëvendësimi i mjeteve që realizojnë transportin e nxënësve; Deklarimi i të ardhurave të krijuara Në FS; Rishikimi i nenit 3 të statutit për burimet e financimit në FS; Arkëtimin e tarifave të shkollimit në universitete
 - b) **Rekomandime të prioritetit të mesëm:**Arkëtimin e të ardhurave nga qiratë;Përditësimi, vlerësimi dhe vetëvlerësimi i dosjeve të punonjësve; Funksionimin e strukturës së Auditit të Brendshëm në universitete; Ndalesa për orë shtesë në kundërshtim me aktet ligjore; Vendosija e sistemit të kontrollit të brendshëm për pagesën e orëve mbi normën e ngarkesës; Shpallja në portalin e DAP të vendeve të lira të punës; Arkëtim për page të marre tepër; Arkëtim i shumës së marë nga sportistët për grumbullim jashtë shtetit; Ndërprerje trajtim të sportistit, në kundërshtim me aktet ligjore

- c) *Rekomandime të prioritetit të ulët.* Mbështetje me fonde e institucionit të BOTEM-it nga MAS; Pagesa e transportit të nxënësve të behet me tarife të plote; Për pagesën e punonjësve për ditët e festave; Për pagesën e punonjësve mësimorë me shkallë të parë të kualifikimit; Për trajtimin e gjyqtareve në FS; Pezullimi i pagesës për anëtarët e asamblesë dhe komitetin drejtues në FS

Përgjigjet dhe reagimet e menaxhimit

Rekomandimet e dhëna janë pranuar nga menaxhimi i institucioneve të audituara, si dhe nga menaxhimi i lartë në Ministri. Nga auditimet që kemi bërë për realizimin e rekomandimeve është konstatuar se nga 127 rekomandimet e dhëna: janë realizuar 95 , në proces brenda afatit 13, të pa realizuara 19;

Veprimtaria zhvilluar e ISHA mbështetur në planin vjetor 2015;

Kjo veprimtaria ka qenë në funksion të misionit për rritjen e cilësisë së shërbimit në arsimin parauniversitar, si dhe inspektimit të zbatimit të kërkesave ligjore në arsimin parauniversitar dhe të lartë. Për këtë ISHA ka kryer monitorimin, vlerësimin, këshillimin dhe nxjerrjen e përfundimeve për zhvillimin e arsimit parauniversitar dhe ka inspektuar nivelin e zbatimit të kërkesave ligjore në arsimin e lartë. *ISHA gjatë vitit 2015 ka realizuar, 18 inspektime të plota* (7 kopshte, 7 shkolla të arsimit bazë dhe 4 të arsimit të mesëm të lartë) në 12 DAR/ZA-të e vendit; **232 inspektime tematike** në 96 kopshte dhe 38 DAR/ZA me fokus zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi; **90 inspektime të orientuara**, për çështje, si:

- vlerësimi i zbatimit të kriterëve të ligjshmërisë në shkollat social-kulturore të vendit;
- zbatimi i ligjshmërisë në shkollat jopublike dhe riinspektim në 10 shkolla për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna;
- vlerësimi i procesit të hartimit dhe zbatimit të planit vjetor të shkollës, të planeve vjetore lëndore dhe i cilësisë në planifikimin e kurrikulës në institucionet arsimore parauniversitare për vitin shkollor 2015-2016;
- vlerësimi i cilësisë së procesit të hartimit të Kartës së Performancës së Shkollës;
- verifikim i plotësimit të dokumentacionit shkollor në ruajtje të përhershme, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
- **500 monitorime lidhur me:**
 - zhvillimin e Provimeve të Maturës Shtetërore në të gjitha DAR/ZA-të;
 - zhvillimin e Provimeve të Lirimit në 13 DAR-e;
 - zhvillimin e olimpiadave të lëndës së matematikës në 13 DAR-e dhe lëndëve matematikë, fizikë, kimi, biologji dhe informatikë në Tiranë;
 - testimet kombëtare të klasave III dhe V në 22 DAR/ZA;
 - zhvillimin e provimit PISA 2015;
 - provimin e kualifikimit të mësuesve në të gjitha qendrat e provimit në Tiranë;
 - votimin e mësuesve për përzgjedhjen e tekstit më të mirë;
 - regjistrimin e nxënësve në klasat e X-ta, në gjimnazet e DAR-it Tiranë;
 - shpërndarjen e teksteve shkollore;
 - testimi e mësuesve në portalin “Mësues për Shqipërinë”.
- ✚ 178 shqyrtime të ankimimeve që kanë ardhur në rrugë zyrtare.
- ✚ 8 aktivitete dhe trajnime nga plani i zhvillimit profesional të stafit, sipas nevojave të identifikuara.

Lloji i inspektimit	Arsimi parauniversitar	Arsimi i lartë	Totali
Inspektime të plota	18	-	18
Inspektime të orientuara	54	36	90
Ankimime	98	80	178
Inspektime tematike	232	-	232
Monitorime	500		500
Totali	902	116	1018

Drejtoria e Financës për vitin 2015 ka realizuar detyra si më poshtë vijon;

1. Detajimi , ndjekja e zbatimi i buxhetit, miratuar me ligjin nr. 160/2014 “Për buxhetin e vitit 2015”,
 - a. Detajimi i Buxhetit për të gjitha institucionet e sistemit të MAS;
 - b. Detajimi i shpenzimeve mujore për të gjitha institucionet e sistemit të MAS;
2. Ndjekja dhe monitorimi i zbatimit të buxhetit për vitin 2015;
3. Përgatitja e raportit vjetor të monitorimit (aneksi 13-të) të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për vitin 2014, si dhe raporti i 3-mujor Janar – Mars 2015 si dhe raporte 6 - mujor, 9 - mujor për vitin 2015.
4. Përgatitja e raportit vjetor të konsoliduar të Pasqyrave Financiare për vitin 2014 , si dhe për Ministrinë e Financave;
5. Hartimi i projektbuxhetit për vitin 2016, si dhe periudhën afatmesme 2016-2018, mbështetja e sektorit të buxhetit në ekipe apo grupe pune në MAS ;(Faza e Pare Mars- Qershor 2015, Faza e dyte Qershor – 1 Shtator 2015)
6. Hartimi i projekt akteve ligjore dhe nënligjore për arsimin parauniversitar dhe universitar në tërësi dhe për pjesën financiare në veçanti, konform Matricës së akteve ligjore dhe nënligjore të parashikuar apër vitin 2015.
7. Planifikimi dhe ndjekja e procedurave për implementimin e projekteve me finacim të huaj, mbështetur ne Planin Vjetor te Reformes si dhe ndjekja dhe monitorimi i projekteve dhe pagesave te projekteve te tjera te huaja (kosto lokale dhe TVSH). Raportimi në Min ekonomisë dhe Ministrinë e Financës për çdo muaj.
8. Monitorime analiza për produktet kryesore, të pagave të punonjësve si dhe shpenzime personeli në Arsim, në IAL publike, transportin e nxënësve dhe mësuesve, bursat dhe kuotat ushqimore, tekstet shkollore dhe kompesimi i tyre, investimet kapitale etj.
9. Pjesëmarrje në grupe pune në MAS për hartimin udhëzimeve rregullore apo monitorime në IAL publike (QSA) si dhe private lidhur me zbatimin e ligjshmërisë së IAL private të pezulluara. “ISSAT”, “IVOCLAR V& P”, “JUSTICIA”, etj.
10. Pjesëmarrje në grupe pune në MAS për hartimin e specifikimeve teknike si dhe fondit limit për procedura prokurimi të parashikuara për vitin 2015.
11. Pjesëmarrje në grupe pune në MAS për hartimin e strategjisë së arsimit “Dokumenti strategjik sektorial 2014-2020, hartimi i projekt strategjia për arsimin përfshirë arsimin parauniversitar dhe arsimin e lartë për periudhën 2015-2020.
12. Hartimi i projektvendimit si dhe hedhja në sistem e projektvendimit.

Fondet e miratuara për këtë program janë 805.7 milion dhe zë rreth 2% të buxhetit të MAS, plani i rishikuar së bashku më të ardhurat për këtë program për vitin 2015 është 742.63 milion lekë. Realizimi për periudhën 12-mujore është **681.9 milion lekë** në këtë program në masëm **92 %** ndaj planit vjetor **ose 1.7%** e totalin e fondeve të realizuara për periudhën 12-mujore të vitit 2015.

Fondet për shpenzime korrente sipas planit 2015 janë 698.6 milion lekë

- a) Fondet për shpenzime personeli në zërin “Pagat dhe sigurimet shoqërore, artikulli 600-601”, arrijnë nga 500.2 milion lekë në vitin 2015 , për periudhën 12-mujore realizimi është në masën **481.3 milion lekë ose në masën 96%,**
- b) **Fondet për shpenzime personeli për vitin 2015 kanë mbuluar pagat si dhe sigurimet shoqërore për 656 punonjës** nga të cilët;
 - ✚ Aparati i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nga 92 në 111 punonjës (pas ndryshimeve të strukturën e miratuar/ ndryshuar për vitin 2014)
 - ✚ Drejtoritë Arsimore Rajonale, 13 drejtori me 270 punonjës e specialistë
 - ✚ Zyrat Arsimore në Rrethe, 25 zyra me 240 punonjës e specialistë;
 - ✚ Inspektoriati Kombëtar i Arsimit, nga 30 në 35 punonjës (pas ndryshimeve të strukturës e miratuar për 2014)
- c) **Fonde për krijimin e kushteve të punës** për rreth 656 punonjës në Aparatin e MAS si dhe DAR/ZA për vitin 2015 janë planifikuar **147.6 milion lekë** në vit , buxheti i rishikuar pas celjes dhe të të ardhurave dhe borxheve 2015 fondet për shpenzime korentë janë në **masën 163 milion,** ku sipas përparësive janë

parashikuar; onde për të mbuluar shpenzimet për energji elektrike, telefon, internet, ujë, karburant, udhëtime e dieta, kancelari, materiale të tjera zyre, si dhe likuidimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Shpenzime për trajnimin e punonjësve të MAS, DAR, ZA në kuadër të sistemit EMIS, trajnimi i drejtorëve të shkollave, trajnimi i specialistëve të sektorit të prokurimeve, sektorit të buxhetit/investimeve etj.

Në këtë program është mbajtur paraysh në detajimin e buxheti për vitin 2015 dhe fondet për internet për 38 institucione DAR/ZA dhe Aparati i MAS, realizimi për periudhën 12-mujore në masën 146.3 milion lek ose në masën 90%.

d) Fondet për shpenzime kapitale për vitin 2015 sipas planit të rishikuar arritën në masën **72.8 milion lekë**, me synim kryesor rritjen e infrastrukturës dhe kapaciteteve menaxhuese.

Burimi tyre është financim nga buxheti i shtetit 72.8 milion lekë, buxheti i rishikuar për vitin 2015 në këtë program për shpenzime kapitale ishte në masën 72.8 milion lekë, realizimi i shpenzimeve kapitale për periudhën 12-mujore në masën 47.7 milion lekë ose në masën 65%, pasi projektet për investime kapitale janë në proces prokurimi.

Sipas projekteve kryesore paraqiten:

- Rikonstruksioni dhe zgjerimi i mjediseve ekzistuese ne MAS në shumën 30.2 milion lekë, realizimi është në masën 24.8 milion lekë.
- Mbikqyrje dhe kolaudim punimesh rikonstruksioni i Godinës së Aparati MAS, në shumën 290 mijë lekë, realizimi është në masën 287 milion lekë.
- Rikonstruksioni dhe zgjerimi i mjediseve ekzistuese ne DAR/ZA në shumën 27.3 milion lekë (Rikonstruksion ZA Kruje, Rikonstruksion godine DAR Lezhe, Rikonstruksion DAR Durrës, Rikonstruksione DAR Berat, Rikonstruksione ZA Gramsh, Rikonstruksione DAR Gjirokastr), realizimi është në masën 22.2 milion lekë.
- Blerja e pajisjeve elektronike/ informatike për shërbimet në MAS, DAR/ZA, në shumën 2 milion lekë, realizimi është në masën 465 mijë lekë.
- e)** Blerja e pajisjeve e mobileri zyre për krijimin e kushteve të punës në MAS, në shumën 10 milion lekë, nuk janë realizuar procedura e prokurimit dhe lidhjes së kontratës.

Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2015, në këtë program është në masën **92%** dhe përfaqëson rreth 1.7% të totalit të shpenzimeve të realizuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për periudhën 12- mujore 2015, sipas zërave kryesore.

Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzime korente	95 %
<u>Realizimi i fondeve buxhetore për shpenzimet kapitale</u>	65 %
Gjithsej	92 %

Në këtë program janë parashikuar për t'u realizuar produktet e mëposhtem, ecuria e të cileve krahasuar me planin vjetor 2015 jepet në tabelën:

Kodi i		Buxheti	Buxheti	Fakti 12-	Realiz ne %
Produktit	Emri i Produktit	Plan 2015	Rishikuar 2015	mujor 2015	I buxhetit per vitin 2015
A	Trajnimi i drejtuesve të shkollave për realizimin e autonomisë së institucioneve arsimore/shkollës në funksion të decentralizimi i shërbimit arsimor	7,500.0	6,124.1	6,124.1	0%
B	Auditimi dhe inspektimi institucioneve te Sistemit te Arsimit	51,788.0	51,788.0	46,885	91%
C	Rritja dhe zhvillimi i kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese, nëpërmjet programeve trajnuese dhe zhvilluese.	10,000.0	10,000.0	9,661	97%
D	Zhvillimi i sistemit të informacionit EMIS në përputhje me standardet operacionale në arsim, nëpërmjet shtrirjes dhe funksionimit të sistemit EMIS në të gjithë DAR/ZA. .	2,400.0	2,400.0	2,400	100%
E	Krijimi i kushteve te punes per punonjesit ne MAS,DAR/ZA dhe ISHA, per rishikimin e akteve ligjore dhe nënligjore të sistemit arsimor	65,000.0	65,000.0	50,049	77%
G	Vlerësimi i punes se punonjesve ne MAS, DAR/ZA.	561,542.0	534,513.0	519,117	97%
H	Blerja e pajisjeve elektronike/ informatike per sherbimet ne MAS,DAR/ZA	2,000.0	2,465.0	465.0	19%
I	Rikonstruksioni dhe zgjerimi i mjediseve ekzistuese ne DAR/ZA	27,300.0	25,115.0	20,017.7	80%
J	Ndertime te reja dhe konstruksione per permiresimi i infrastruktures ne MAS,	72,700.0	33,024.6	25,024.0	76%

L	Blerja e pajisjeve e mobileri zyre per krijimin e kushteve te punes ne MAS,DAR/ZA	5,000.0	12,200.0	2,156.0	18%
	Shpenzime jashte buxhetore		742,629.7	681,898.5	92%
	Totali	805,730.0	742,630.1	681,898.2	92%

Faktorë që kanë ndikuar në realizimin e buxhetit për vitin 2015;

- Nuk janë realizuar me sukses nga DAP, procedurat e punësimit dhe plotësimin e organikës së miratuar për Aparatin e MAS konform ligjit të shërbimit Civil.
- Ka pasur vonesa në prokurimin e fondeve “Rikonstruksion në DAR Durrës”, për shkak të kalimit të në administrim të mjediseve të Godinës nga Bashkia Durrës në përdorim të DAR Durrës, kjo procedurë nuk është zhvilluar.
- Ka pasur vonesa në prokurimin e fondeve “Blerje Pajisje mobileri për Aparatin e MAS”, për shkak të lidhjes të kësaj procedure me zhvillimin e procedurës dhe realizimine kontratës për Rikonstruksionin e Godinës së Aparatit të MAS, kjo procedurë nuk është zhvilluar.

II - ARSIMI BAZË. (Titulli buxhetor i programit 09120)

Sigurimi i një arsimit cilësor dhe për të gjithë nxënësit duke përmirësuar kushtet e mësimdhënies e mësimnxënies duke siguruar kushte të barabarta për pjesëmarrje në arsimin bazë, për të gjithë fëmijët e grup moshës në arsimin parashkollor dhe atë të detyruar.

Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës me synim plotësimin e standardeve Europiane. Rritja e aksesit në AP, përfshirja e 100% e fëmijëve 5 vjeçare në klasat përgatitore; Rritja e viteve të shkollimit. Rritja e autonomise se shkollave; Ulja e nxënësve që braktisin shkollën në AB, Tërheqja e fëmijëve romë/egjiptian në AB Rehabilitimi/ndërtimi i kopshteve /shkollave sipas standardeve. Rritja e cilësisë së mësimdhënies, trajnimi i mësuesve, pajisja e shkollave me laborator shkencorë e IT,; krijimi i bibliotekave dixhitale për kurrikulën e AB, Shtrirja e shërbimit te punonjesit social dhe psikologut sipas standardeve të krahasuara me ato të vendeve të zhvilluara. Objektivat kryesore :

Objektiv 1). Të sigurohet rritja e aksesit të fëmijëve në arsimin parashkollor deri në nivelin 74%. Modernizimi i arsimit parashkollor, përmes miratimit të standarteve të të nxënës, trajnimit të mësuesve (15-20% në vit), rikonstruksionit dhe ndërtimit (150 -200 klasa në vit) të kopshteve dhe pajisjes me materiale didaktike.

Objektiv 2). Hartimi i kurrikulës së re (kl 1 dhe kl 6), përgatitja e 50 moduleve trajnuese për kurrikulën e re, të 5 moduleve për nxënësit me aftësi të kufizuara (AK). Trajnimi i mësuesve të AB dhe të diasporës (70 mësues nga diaspora) për zbatimin cilësor të kurrikulës dhe 25 % e mësuesve të AB.

Objektiv 3). Përmirësimi i cilësisë së teksteve shkollore dhe kompensimi 100% nga klasa I-IX për nxënësit romë, egjiptianë, fëmijëve që gëzojnë statusin ligjor të jetimit, fëmijëve që gëzojnë statusin e të verbrit, fëmijëve të pakicave kombëtare, fëmijëve të familjeve të emigrantëve që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, fëmijëve që vijnë nga familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie; fëmijë të familjeve që kanë në përbërjen e tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, fëmijë që vijnë nga familje ku kryefamiljari përfiton pension pleqërie shteti dhe kanë fëmijë në ngarkim, të cilët janë pa të ardhura; familje në nevojë, vikativave te trafikimit, 4000 nxënës

Objektiv 4). Sigurimi i një arsimit cilësor për fëmijët në nevojë, (rritja e treguesit të regjistrimit me 20% ose 400 fëmijë për nxënësit romë dhe egjiptianë, 2% për nxënësit me AK. Rritja me 15 % e numrit të mësuesve ndihmës për nxënësit me AK. Sigurimi i transportit të nxënësve për ndjekjen e AB. Uljen e braktisjes shkollore në AB në 0.4%. Trajtimi i diferencuar i mësuesve (20-25%) që, do të punojnë me fëmijët që kanë braktisur shkollën për riintegrimin e tyre.

Objektiv 5). Konsolidimi i shërbimit psikolo-social nëpërmjet ngritjes së njësisë së shërbimit psiko-social në njësitë arsimore vendore. Trajnimi i vazhdueshëm i psikologëve (150) dhe punonjësve socialë (150). Ngritja e mekanizmit të supervizimit të shërbimit psiko-social dhe e kapaciteteve të tyre. Modernizimit i kabineteve të

shërbimit psiko-social (kompjuter, printer, telefon) dhe pajisja me instrumentet e punës (teste vlerësimi, dosje individuale për çdo nxënës, manuale pune).

Objektiv 6). Arsimi cilësor e gjithëpërfshirës me synim plotësimin e standardeve Europiane: ndërtime të reja e rehabilitim të objekteve arsimore 450 - 500 klasa e sigurimi i pajisjes së tyre. Pajisja e 20-25% të shkollave të AB me laborator shkencorë, IT synimi një kompjuter për dy nxënës në orë mësimi, laboratorë virtual e biblioteka dixhitale në AB (të paktën 1 set laptop-projektor për çdo shkollë).

Objektiv 7). Trajnimi i 400 mësuesve të arsimit bazë për përdorimin e sistemit e-learning. Trajnimi i 2400 mësuesve të arsimit bazë për amzën digjitale.

Arritje për vitin 2015;

- Arsimimi në fëmijërinë e hershme.** Në Shqipëri, 74-76% e fëmijëve të grup moshës 3-5 vjeç (treguesi NER) dhe 83% fëmijëve 3-6 vjeçarë (treguesi GER), ndjekin institucionet parashkollore (Instat 2012-2013). Në vitin shkollor 2014-2015 numri total i fëmijëve 3-6 vjeçarë në kopshte ishte 82,494, nga të cilët 77,154 ose 94 % frekuentonin kopshtet publike dhe 5 340 ose 6% fëmijë ato private, më shumë se 4371 fëmijë nga të cilët 1,926 femra dhe më shumë se 610 fëmijë romë kanë ndjekur arsimin parashkollor.

Numri i Nxënësve, Institucioneve dhe Mësuesve në Arsimin Parauniversitar, Viti Shkollor 2014-2015, Arsimi Publik dhe Privat							
	Numri i Nxënësve, Institucioneve, Mësuesve dhe Përqindjet përkatëse sipas Niveleve të Arsimit						
	Gjithsej në Arsimin Parauniversitar	Arsimi Parashkollor (AP)	Përqindja Nx. AP / Gjithsej	Arsimi Bazë (AB)	Përqindja Nx. AB / Gjithsej	Arsimi i Mesëm (AM)	Përqindja Nx. AM / Gjithsej
Nr. i Nxënësve	585,945	82,494	14.08%	363,408	62.02%	140,043	23.90%
Nr. Institucio	3,569	1,857	48.88%	1,493	39.30%	497	13.08%
Nr. i Mësuesve	37,943	4,495	11.85%	24,777	65.30%	8,671	22.85%

- Është planifikuar dhe po përgatitet përfshirja graduale e klasës përgatitore në arsimin e detyruar. **Është hartuar dhe filloi pilotimi I paketës së re kurrikulare për klasën përgatitore** dhe klasën e parë të arsimit fillor. Paketa e re kurrikulare e cila përshin kornizën, kurrikulën bërthamë, programet dhe fushat e të nxënës do të pilotohet në 26 klasa përgatitore dhe të para, nga ku do të përfitojnë rreth 780 nxënës.

- Arsimi gjithëpërfshirës.** Gjatë vitit shkollor 2014-2015 e ndoqën arsimin parauniversitar 4 371 fëmijë romë, 152 më shumë në krahasim me vitin shkollor 2013-2014. Për herë të parë, u identifikuan 93 mësues romë dhe egjiptianë të diplomuar për mësuesi, prej të cilëve janë punësuar në sistem 86% e tyre (80 mësues): 10 në arsimin parashkollor, 21 në klasat I-V; 35 në klasat VI-IX (1 egjiptian drejtor shkolle në Dibër) dhe 14 në arsimin e mesëm të lartë. Të 35 mësuesit romë janë të punësuar sipas profilit të diplomës që zotërojnë.

Reformimi i kurrikulës së arsimit parashkollor, bazë dhe të mesëm;

Pilotimi i kurrikulës në 26 shkolla 9 vjeçare: 13 në qytet dhe 13 në fshat, në të cilat janë përfshirë në pilotim 26 klasa përgatitore (13 qytet & 13 fshat), 39 klasa të para (26 qytet & 13 fshat) dhe 39 klasa të gjashta (26 qytet & 13 fshat). Trajnimi i 480 specialistëve të DAR/ZA-ve, drejtues dhe mësues që u përfshinë në pilotim. Vlerësimi i pilotimit për 26 drejtues të shkollave pilot, 313 mësues të përfshirë gjatë vitit shkollor 2014-2015 në procesin e pilotimit, 629 nxënës të klasave të gjashta dhe 565 prindër.

Zhvillimi profesional i mësuesve

Zhvillimi i testimit për evidentimin e nevojave për trajnim të mësuesve të arsimit bazë dhe të mesëm.

Organizimi i trajnimeve të mësuesve të klasave të para, të gjashta, përgatitor, si dhe të drejtuesve të institucioneve arsimore. Zhvillimi i trajnimit për 1000 mësues për të qenë bashkëtrajnerë me specialistët e IZHA në seancat trajnuese për mësuesit e klasave të para, të gjashta dhe përgatitor në çdo DAR.

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të arsimit parauniversitar sipas standardeve bashkëkohore të cilësisë.

Për vlerësimin e arritjeve të nxënësve sipas standardeve bashkëkohore të cilësisë, u pilotua testimi i nxënësve të klasës së tretë dhe të pestë sipas standardeve të PISA-s. Ky testim u krye me një kampionim prej 3000 nxënësish, i shtrirë në të gjithë vendin.

U realizua Konferenca për prezantimin e raportit dhe të analizës së vlerësimit të kryer

U zhvilluan sesioni i parë dhe i dytë i provimeve të Maturës Shtetërore 2015. Në Maturën Shtetërore 2015 morën pjesë 46070 maturantë nga i gjithë vendi. Në mbyllje të Maturës Shtetërore 2015, për të dy sesionet, rezultuan kalues në Maturën Shtetërore 2015 rreth 32149 maturantë ose 69,7%.

Monitorimi i MSH (gjatë provimeve dhe gjatë vlerësimit të testeve në qendrat e vlerësimit).

Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit për ofrimin e testeve “APTIS for Teens” për arsimin baze dhe “TOEFL Junior” për Maturën Shtetërore. Zhvillimi i provimeve të Lirimit Zhvillimi i olimpiadave

Promovimi i cilësisë dhe i vetëvlerësimit të performancës së institucioneve të arsimit parauniversitar

Në bashkëpunim me DAR/ZA, IshA, është plotësuar Karta e performancës së shkollës nga të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar. Të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar përdorin KP për vlerësimin e brendshëm të arritjeve.

Realizimi i renditjes së shkollave sipas treguesve të KP për vitin 2014-2015 në cdo DAR/ZA

Aktiviteti promovues për rrituesit e olimpiadave në cdo DAR dhe në MAS

Reformimi i procesit të tekstit shkollor

Përmirësimi i sistemit të recensionimit dhe ai përzgjedhjes së teksteve shkollore.

Në funksion të rritjes së cilësisë në përmbajtje, u kufizua në jo më shumë se tri për çdo lëndë/fushë të nxënësi numri i alternativave të teksteve shkollore.

U miratuan standardet për hartimin dhe recensionimin e teksteve.

U realizua projekti për digjitalizimin e shkollave shqiptare, nëpërmjet integritetit të teknologjisë informatike në arsimin e mesëm përmes përzgjedhjes së 60 shkollave të mesme (gjimnaze dhe gjimnaze gjuhësore), për të qenë pjesë e fillimit të procesit të digjitalizimit të nxënies me tableta.

Miratimi i katalogut të teksteve shkollore digjitale për klasat e 10-ta, pjesë të projektit të digjitalizimit të klasave me tableta.

Projekti “Shkollat si qendra komunitare”

Hartimi i standardeve dhe udhëzuesit të përdorimit të miratuar nga MAS. Shtrirja në 222 shkolla nga 184 deri në fund të vitit akademik 2014-2015.

Realizimi i aktivitetit “Panairi i ideve”, Shkollat të mbështetura nga Ministrat dhe përfshirja e një numri shkollash me donatorë kryesisht shkolla të mbështetura nga Ëorl Vision. Trajnimi kombëtar i koordinatorëve të DAR/ZA-ve, Shkollave dhe prindërve pjesë e nismës. Ky trajnim u realizua nga DAPU, IZHA dhe u mbështet nga Ëorl Vision për logjistiken dhe Save the Children për përgatitjen e manualit të trajnimit i cili iu la për vëllim koordinatorëve në DAR/ZA. Realizimi i portalit të menaxhimit të planit të veprimtarive në shkolla. Ky portal synon një përmirësim të efektivitetit të nismës në shkolla përmes sistemit elektronik të vetëvlerësimit. Portali do të mbështesë shkollat në përgatitjen e planeve të veprimit nisur nga nevojat reale të tyre. Ky portal u hartua nga IZHA dhe u mbështet nga Ëorl Vision.

Hartimi i vlerësimit të jashtëm i SHQK nga UNICEF dhe raporti me gjetjet e tij është diskutuar me koordinatorët e DAR/ZA dhe institucionet bazë DAPU dhe IZHA.

U hartua plani kombëtar i veprimit “Stop dhunës në shkolla” për vitin shkollor 2015-2016, i cili ju është dërguar DAR/ZA-ve për zbatim.

Arsimi i fëmijëve shqiptarë në diasporë

Organizimi dhe realizimi i Seminarit trajnues me mesuesit, “Për mesimin plotësues në gjuhën shqipe në diasporë” me 27-30 Korrik 2015 në qytetin e Pejës.

Blerja e teksteve mësimore për vitin 2015-2016, për fëmijët shqiptarë në diasporë.

- ✚ **Realizimi i pilotimit të klasave 2 dhe 7 organizohet pas krijimit të një përvoje paraprake nga pilotimi i klasave 1 dhe 6.** Vjelja e kësaj përvoje ishte një ndër objektivat përgatitjes për pilotimin në klasat 2 dhe 7. Në këtë kuadër janë realizuar veprimtaritë e mëposhtme: U analizuan rezultatet e pilotimit dhe të e dialogut me mësuesit pilotues të kurrikulës së klasave K, 1 dhe 6.; U rishikuan objektivat e pilotimit; U përgatitën modulet e reja të trajnimit ; U hartua platforma e re e pilotimit; U monitoruan shkollat pilot nga specialistët përgjegjës për shkollat pilot në cdo DAR; U mor informacion nga mësuesit e shkollave pilot për mbarëvajtjen e pilotimit dhe për probleme që kanë dalë gjatë kryerjes së tij, me qëllim që të ofrohet ndihma e kërkuar; U përpunua informacioni i marrë nga mësuesit dhe, mbi këtë bazë, u hartua plani i këshillimit dhe trajnimit (për çështje të caktuara) të mësuesve në pilotim.
- ✚ **Në funksion të fazës së pilotimit dhe të përgatitjes për hartimin e teksteve shkollore:** U rishikuan programet e klasës së 2-të; U rishikuan programet e klasës së 3-të; U rishikuan programet e klasës së 7-të dhe; U rishikuan programet e klasës së 8-të. Programet e klasës së dytë dhe të shtatë do të jenë objekt i pilotimit gjatë këtij viti shkollor
- ✚ **Zhvillimi profesional i mësuesve** Sipas planit vjetor të IZHA-s kualifikimi i mësuese ka kaluar etapën e përgatitjes së testeve, procesin e provimit më datë 3 maj dhe korrigjimin e tyre. U përgatitën testet për atestim , ju nënshtruan provimit të atestimit 3500 mësues. u korrigjuan teste Brenda afateve të përcaktuara nga MAS, u prodhuan certifikatat (prokurim), u analizuan rezultatet.
- ✚ Në periudhën maj –korrik 2015, **u realizua trajnimi i të gjithë mësuesve të klasave të para dhe të gjashta** në nivel kombëtar. Numri total i mësuesve të trajnuar është 11.000 në të gjithë Shqipërinë;
- ✚ Në procesin e kualifikimit për vitin 2015, **paraqitën portofolin dhe aplikuan 3519 mësues të të gjitha cikleve dhe drejtues të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme.** Nga këta 3452 kandidatë morën pjesë në testimin e datës 18 Prill 2015.
- ✚ Në vitin shkollor 2015-2016 kurrikula e re u zbatua në sistem për klasat 1 dhe 6. Në këtë kuadër janë realizuar trajnime të të gjithë mësuesve që japin mësim në këto klasa. **Veprimtaritë e organizuara për realizimin e këtij objekti**
 - a) realizimi i seancave informuese me specialistë të DAR-eve për dokumentet kurrikulare;
 - b) realizimi i trajnimeve të vazhdueshme në të 13-të DAR-et e vendit (50 specialistëve të DAR/ZA-ve dhe 400 mësuesve të shkollave pilot);
 - c) përgatitja e moduleve të trajnimit lidhur me planifikimin, vlerësimin e nxënësit, situatat e të nxënësit për akreditim;
 - d) hartimi i skemës së trajnimit për të gjithë mësuesit që japin mësim në klasa 1 dhe 6.
 - e) realizimi i trajnimeve në të 13-të DAR-et e vendit, qershor – korrik 2015;
 - f) trajnimi i rreth 12 000 mësuesve dhe drejtuesve për zbatimin e kurrikulës së re;
 - g) plotësimi i databazës së 12 000 mësuesve të trajnuar për arsye certifikimi;
 - h) organizimi i trajnimeve me mësues të shkencave ekzakte (matematikë, fizikë, biologji).
- ✚ **Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara.** Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara realizohet në disa forma: Në institucione të veçanta siç janë institutet kombëtare. Në klasa të veçanta brenda shkollave 9-vjeçare. Në “Qendra ditore”, të specializuara; Në kopshte dhe klasa normale të arsimit bazë, ku ka të integruar përkatësisht 320 dhe 2000 fëmijë më AK. Politikat e arsimit gjithëpërfshirës që zbaton MAS, synojnë që krahas edukimit dhe arsimit të arrihet edhe rehabilitimi maksimal i mundshëm i fëmijëve më AK. Është realizuar baza e të dhënave për fëmijët me aftësi të kufizuara në arsimin parashkollor dhe bazë. MAS në bashkëpunim me “Save the Children”, UNICEF dhe partnerë të tjerë : Ka përfunduar studimin kombëtar analitik **“Situata e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e arsimit 9-vjeçar”** për vitin 2011-2012, nga ku

rezulton se: 511 ose 22% e fëmijëve më me AK të moshës 3-6 vjec ndjekin kopshtet normale dhe 3167 ose 58% e fëmijëve me AK të grupmoshës përkatëse ndjekin shkolla normale të arsimit bazë. Po harton kurrikulën e programit trajnues bazë për aftësinë e kufizuar, për mësuesit në shërbim. Në cdo DAR/ZA janë ngritur dhe funksionojnë Komisionet Multidisiplinare të vëlrësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Teknologjia e informacionit dhe komunikimit Synimi: Mbështetja e procesit të të nxënësve për të gjithë duke integruar në mënyrë efektive dhe cilësore teknologjinë e informacionit dhe komunikimit në të gjitha nivelet arsimore, duke i kushtuar vëmendje të veçantë zhvillimit të kurrikulave me fokus në sigurinë e nxënësve nga interneti, si dhe zhvillimin e kompetencave digjitale.

- U integrua TIK në të gjitha nivelet arsimore;
- U hartua udhëzuesi për zbatimin e standardeve të TIK-ut në shkollë, për drejtuesit dhe mësuesit.
- Zhvillimi profesional i mësuesve për zbatimin e standardeve të TIK-ut në shkollë.
- Ndërtimi i orëve interaktive në kurrikulën e gjimnazit në lëndët bazë të kësaj kurrikule.

Fondet e rishikuara për këtë program për vitin 2015, janë në masën **24 miliard e 887.6 milion lekë**. Fondet e programit të arsimit bazë të arrijnë 60.7 % e fondeve të MAS, fondet e rishikuara për këtë program për vitin 2015 janë në 24 miliard e 358.9 milion lekë , së bashku me të ardhurat dytësore dhe të projekteve donatore arriten në 24 miliard e 358.9 milion lekë ose në 55.5 %. Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2015 është në masën 24.1 miliard lekë ose në 99% e fondeve të rishikuara të programit. Fondet e arsimit bazë zënë rreth 56% të totalit të shpenzimeve të realizuara për periudhën 12-mujore për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, **si dhe 5.28% ndaj shpenzimeve publike dhe 1.67% ndaj PBB%.**

Në strukturën totale buxhetit, fondet i arsimit bazë **pa u përfshirë shpenzimet e njësisve të qeverisjes vendore** arrijnë në 5.72% ndaj shpenzimeve publike, ose 1.81% të PBB.

- A. **Për vitin 2015** në grupin e shpenzimeve për personelin janë miratuar **21 miliard e 907 milion lekë** për mbulimin e pagave dhe të sigurimeve shoqërore për rreth 29 817 punonjësve të arsimit 9-vjeçar, të cilët ofrojnë shërbime arsimore rreth **78,416 fëmijëve** që ndjekin arsimin parashkollor, si dhe për rreth **356,347 nxënës** në arsimin 9-vjeçar. Fondet për shpenzime personeli për periudhën 12-mujore janë realizuar në shumën e **21 miliard 770 milion lekë** ose në masën 99.5% ndaj planit të miratuar për vitin 2015.

Për vitin 2015, në programin e arsimit bazë u siguruan kushte për kryerjen e praktikës profesionale për rreth 1100- 1200 praktikantë konform Vendimit nr. 197, datë 4.3.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e numrit të praktikantëve “për kryerjen e praktikës profesionale” me kontratë të përkohshme, për periudhën 1 janar deri 15 qershor dhe 15 shtator deri 31 dhjetor 2015, për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit”.

Për vitin 2015, në arsimin 9- vjeçar dhe të mesëm janë dhënë shpërblim për **5038 nxënës me 5 000 lekë** duke përfituar rreth 25.2 milion lekë, si dhe shpërblimi për 500 mësues me arritje të larta për vitin 2015 me 40 000 lekë për cdo mësues me një efekt financiar prej 20 milion lekë.

- B. **Fonde buxhetore për krijimin e kushteve të punës** të palnifikuara për vitin 2015, në artikullin (602-606) janë parashikuar **950 milion lekë, buxheti i rishikuar** për periudhën 12-mujore 2015 në këtë program është në masën 1 miliard e 71.6 milion lekë, **realizimi vjetor** shpenzimeve korente 602-606 është në masën 995.8 milion lekë ose në masën 93% e planit të rishikuar.

Fonde buxhetore të miratuara në këtë program mbulojnë shpenzimet për ofrimin e shërbimeve arsimore për rreth **78 416 fëmijë në arsimin parashkollor, si dhe 356 347 nxënës në arsimin 9-të vjeçar,** më të detajuara si më poshtë vijon;

29. Për vitin 2015, **u siguroi i financimit të shërbimit të transportit** për rreth 32.000 nxënës që mësojnë në një distancë prej më shumë se 2 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre si dhe rreth 12 000 mësuesve që punojnë

e banojnë më shumë se rreth 5 km nga vendbanimi i tyre **dhe për herë të parë janë përfshirë në këtë skemë financimi dhe fëmijët të arsimit parashkollor si dhe edukatorët e kopshteve.**

30. **U realizua rimbursimi i shpenzimeve të blerjes së teksteve shkollore** për vitin akademik 2015-2016 për rreth 100 mijë nxënës të kategorive të veçanta dhe shtresa në nevojë, ose për rreth 23-25% të totalit të nxënësve me rreth 300 milion lekë për herë të parë janë përfshirë për herë të parë në skemën e financimit dhe tetë kategori sociale **më shumë se 15 000 nxënës** të kategorive të veçanta dhe shtresa sociale në nevojë **me rimbursim në masën 100 për qind të tij çmimi i blerjes së teksteve shkollore nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në formën e “Transfertes tek individët”**. Vetëm për nxënësit e arsimit 9-vjecar, shpenzime për në artikullin 606 për kompesimi i blerjes së teksteve shkollore është në masën **246 milion lekë** ku përfituan rimbursim rreth 84,000 nxënës nga të gjitha kategoritë sociale si më poshtë;

- a) **Fëmijët që vijnë nga familje që kanë në përbërjen e tyre anëtarë me aftësi të kufizuar**, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP-së), sipas pikës 3 të nenit 7 të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar.
- b) **Fëmijët vijnë nga familje ku kryefamiljari përfiton pension invaliditeti.**
- c) **Për fëmijët e moshës shkollore të arsimit bazë, viktimat të trafikimit**, të cilëve u ofrohet ndihmë dhe asistencë nga Qendra Kombëtare e Pritjes së Viktimave të Trafikimit, Qendra Kombëtare e Viktimave të Dhunës në Familje dhe Qendra Kombëtare Tranzitore të Emergjencës, sipas kërkesës zyrtare për sasinë e teksteve shkollore të nevojshme.
- d) **Për fëmijët e moshës shkollore të arsimit bazë, që gëzojnë statusin e viktimës/viktimës së mundshme** të trafikimit në përputhje me Vendimin nr. 582, datë 27.07.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Procedurave Standarde të veprimit për Identifikimin dhe referimin e viktimave/ Viktimave të Mundshme të Trafikimit”.
- e) **Për individët e moshës shkollore të arsimit bazë, të cilët janë në institucionet e paraburgimit/vuajtjes së dënimit.**
- f) **Për fëmijët e moshës shkollore të arsimit bazë, të shtruar në Shërbimin Onkologjik në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”**. Kërkesa dhe sasia për tekstet shkollore dërgohet nga ky shërbim në muajin gusht të çdo viti.
- g) **Për fëmijët e policëve të rënë në detyrë.**
- h) **Për çdo fëmijë që është i treti e më lart në radhën e shkollimit të fëmijëve të së njëjtës familje.**
- i) **Për tekstet shkollore të fëmijëve egjiptianë, nga klasa I deri IX**, çmimi i blerjes së tyre të mbulohet 100% nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Drejtoritë përkatëse të shkollave, ku mësojnë nxënës egjiptianë, duhet të dorëzojnë në njësitë arsimore vendore Drejtoritë Arsimore Rajonale/ Zyrat Arsimore përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve të kësaj kategorie.
- j) **Për tekstet shkollore të fëmijëve, nga klasa I deri IX, të cilët janë përfitues në institucionet e përkujdesit social rezidencial publik**, në Qendra Kombëtare të Pritjes së Viktimave të Trafikimit, Qendra Kombëtare të Viktimave të Dhunës në Familje dhe Qendra Kombëtare Tranzitore të Emergjencës, çmimi i blerjes së tyre të mbulohet 100% nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Drejtoritë përkatëse të shkollave, ku mësojnë nxënës, duhet të bashkërendojnë punën me drejtoritë e institucioneve të cituara më lart dhe dorëzojnë në Drejtoritë Arsimore Rajonale/ Zyrat Arsimore përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve të kësaj kategorie.

31. **Fonde buxhetore për të mbuluar shpenzimet e bursave** për 322 nxënës romë dhe egjiptianë me afro 4.2 milion lekë në vit.
32. **Fonde buxhetore për të mbuluar shpenzimet për institucionet special** për nxënësit që nuk dëgjojnë dhe nxënësit nuk shikojnë për rreth 220 nxënës që nuk dëgjojnë dhe nuk shikojnë me afro janë planifikuar 111.6 milion lekë dhe janë realizuar 105.8 milion lekë në vit ose rreth 95%.
33. **Fonde për shërbimin e internetin në shkollat e arsimit 9-vjecar, për vitin 2015 janë parashikuar rreth 50 milion lekë** (vetëm për periudhën pas përfundimit të kontratës me Albtelekom si dhe përcaktimit të numrit të shkollave që nuk do të përfitojnë internet nga “Posta Shqiptare”).
34. Shpenzime për trajnime të mësuesve në DAR, që punojnë me nxënës nga shtresat e marxhinalizuara, si dhe uljen e braktisjes **8.6 milion lekë**;

35. Shpenzime për blerje dokumentacion shkollor DAR/ZA, **janë planifikuar 10 milion lekë**, janë realizuar me sukses procedurat dhe janë likuaduar 5 milion lekë,
36. Shpenzime për blerjen e teksteve shkollore për fëmijët në diasporë **3.5 milion lekë i rishikuar 12 milion lekë, nuk janë realizuar me sukses procedurat e prokurimit.**
37. Shpenzime për blerje pulla me hologram **janë planifikuar dhe realizuar 3.5 milion lekë**, janë realizuar procedurat dhe janë likuaduar 1.95 milion lekë.

Në total në grupartikullin e *shpenzimeve operative* artikulli 602-606, buxheti i rishikuar 1 miliard e 71.6 milion lekë dhe për periudhën **12-mujore 2015** janë realizuar në shumën 995.8 milion lekë ose në masën 93%.

Shpenzimet për investime kapitale në programin Arsimi Bazë, janë për vitin 2015 u miratuan në shumën **1 miliard e 354 milion lekë** me burim financim i brendshëm 100% , buxheti i rishikuar për vitin 2015 ishte në masën 1 miliard e 347 milion lekë. Realizimi për vitin 2015 është në masën **1 miliard e 290.1 milion lekë ose në masën 96%**. Sipas projekteve prioritare paraqiten:

Investime pjesë e fondit të zhvillimit të rajoneve për vitin 2015, si dhe detyrime nga viti 2012-2013, të miratuara në vitin 2015, arrijnë në shumën prej rreth **1 miliard 180.6 milion lekë**, nga të cilat;

Janë financuar me përparësi **86 objekte arsimore**, me një vlerë prej **1 miliard e 180.6 milion lekë** për ndërtime dhe rikonstruksionine, supervizime të objekte arsimore të miratuara me FZHR 2015, realizimi është në masën **1 miliard 123.4 milion lekë** ose 95% e fondeve të miratuara, nga të cilat:

- ✚ **Për ndërtime të reja dhe shtesa të objekteve arsimore në 25 objekte arsimore** të miratuara me Vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve në 2015 (thirrje I+ thirrje II) me vlerë financimi për vitin 2015 në shumën 352.7 milion lekë, realizimi është në masën 383.9 milion lekë ose 96.3% e fondeve të miratuara, me objektiv sigurimin dhe përmirësimin e kushteve të infrastrukturës në mjediset e sistemit para universitar, shmangien dhe reduktimin e zhvillimit të mësimit me turne, reduktimin e numrit të nxënësve për klase, me synim realizimin që të gjithë shkollat në zonat urbane të qyteteve kryesore të vendit të arrihet raporti 30 nxënës/klasë;
- ✚ **Për rikonstruksione në vitin 2015** janë financuar gjithashtu rreth **47 projekte/kontrata / objekte** në vazhdim nga viti 2013-2014, nga të cilat 28 kontrata janë të miratuara në vitin 2015, në vitin 2015 me rreth **743 milion lekë**, realizimi është në masën 704.7 milion lekë ose 95% e fondeve të miratuara. U siguruar financimi për celjen e **28 projekteve të reja të arsimit parauniversitar me vlerë 462.2 milion leke** (thirrja I+Thirrjen II 2015) me vlerën e plotë objekteve të reja në shumën prej 940,139,679 lekë.
- ✚ **Janë financuar dhe përfunduar 11 projekte për ristrukturimin e 44 terrene sportive në 12 NJQV** në qarqet kryesore të vendit, me vlerë rreth 83.9 milion lekë, realizimi është në masën 78.7 milion lekë ose 94% e fondeve të miratuara.
- ✚ **Janë financuar 162.6 milion lekë për pajisje mobiliere** për afro **80 objekte arsimore** që përfundojnë punimet në vitin 2015 kontrata është realizuar 100% duke realizuar pajisjen shkollave të arsimit para universitar, të cilat kanë pasur mungesa apo pajisje të amortizuara tërësisht dhe që kanë nevojë emergjente për rinovim.

Realizimi i shpenzimeve kapitale për 12 mujorin 2015 në këtë program është **1 miliard e 290 milion lekë** ose 96 % të buxhetit të planifikuar. Në total realizimi i fondeve për programin buxhetor të arsimit bazë për 12- mujorin 2015 në këtë program është realizuar në masën 24 miliard e 87 milion lekë ose 99 % dhe përfaqëson rreth 61.5 % të fondeve të arsimit të realizuara të fondeve të MAS.

Sipas grup artikujve të dhënat janë sa vijon;

Shpenzimet korente	99 %
Shpenzimet kapitale	96 %
Gjithsej	99 %

Në këtë program janë parashikuar për t'u realizuar produktet e mëposhtem, ecuria e të cileve krahasuar me planin vjetor paraqitet ne tabelën ne vijim

Në mijë lekë

Kodi i Produktit	Emri i Produktit	Buxheti Plan 2015	Buxheti Vjetor Rishikuar 2015	Fakti 12-mujor 2015	Realiz ne % I buxhetit per vitin 2015
A	Ndertimi i shkollave/kopshteve te reja	559,097.0	352,694.0	338,694.0	96%
A	Bibloteka shkollore te krijuara sipas standardeve	0.0	0.0	0.0	0%
A	Reabilitimi i kopshteve dhe shkollave per rritjen e aksesit të fëmijëve 5 vjeçar me 10% dhe fëmijëve 3-4 vjeçarë	645,611.0	832,048.0	788,808.0	95%
A	Furnizimi me pajisje mobilierie i shkollave dhe kopshteve te reja dhe te rehabilituara	150,000.0	162,626.0	162,621.0	100%
B	Zhvillimi dhe konsolidimi i shërbimit arsimor ne sistemin PARASHKOLLOR, per permbushjen e funksioneve te edukimit dhe realizimin e misionit te edukimit.	3,044,800.0	2,904,800.0	2,785,752	96%
C	Trajnimi i mësuesve te arsimit baze, per implementimin e kurikulave e programeve mesimore, rritjen e kompetencave profesionale	28,600.0	28,600.0	28,600.0	100%
D	Realizimi i shërbimit arsimor ne sistemin 9 vjecar, per permbushjen e funksioneve te edukimit dhe realizimin e misionit te edukimit.	19,487,865.0	19,010,012.8	18,924,731	100%
E	Sigurimi i një arsimit cilësor për fëmijët në nevojë,	110,369.0	110,369.0	110,369.0	100%
A	Zhvillim i reformes se teksteve shkollore për AB, si dhe kompesimin financiar te nxenesve nga shtresat sociale ne nevojë per nxenes me kerkesa te vecanta, nxenes qe nuk shikojne, nxenes nuk degjojne, nxenes me PLM, rome, egjiptiane etj.	252,000.0	313,164.8	307,100.1	98%
F	Shërbim transporti per nxenes e mesues qe punojne mbi 5 km nga vend banimi i tyre dhe të nxënësve që punojnë e mësojnë mbi 2km jashtë vendbanimit,	555,780.0	555,780.0	555,780.0	100%
G	Hartimi i kurrikulës lëndore (kl 2 dhe kl 7). Përgatitja e 40 moduleve trajnuese për kurrikulën e re, si dhe 8 moduleve për punën me nxënësit me aftësi të kufizuara.	45,106.0	46,401.9	43,093.2	93%
H	Trajnimi i 400 mësuesve të arsimit bazë për përdorimin e sistemit e-learning. Trajnimi i 2400 mësuesve të arsimit bazë për amzën digjitale.	8,400.0	10,400.0	10,400.0	100%
		24,887,628	24,326,897	24,055,948	99%
	Shpenzime jashte buxhetore	0	32,002	32,002	100%
	TOTALI	24,887,628	24,358,898	24,087,949	99%

Nga tabela e mësipërme del që disa produkte nuk janë realizuar në masën 100% për 12-mujorit 2015;

1. Reabilitimi i kopshteve dhe shkollave per rritjen e aksesit të fëmijëve 5 vjeçar me 10% dhe fëmijëve 3-4 vjeçarë;
2. Ndertimi i shkollave/kopshteve te reja; për shkak të hartimit të projekte me cilësi të dobët të zhvilluara nga Njësitë e Qeverisjes Vendore për vitin 2015 (Bashkia Durrës , Bashkia Sarandë si dhe njësi të tjera të qeverisjes vendore.).
3. Projekte të zhvilluara me cilësi të dobët nga Njësitë e Qeverisjes Vendore për vitin 2015 ose që kanë pasur nevojë për rishikim të standardeve (Bashkia Durrës, Bashkia Sarandë si dhe njësi të tjera).

Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit për 12- mujorin 2015:

1. Vendimarrja me vonesë e komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, për fondet e zhvillimit të rajoneve 2015, nuk janë realizuar vetëm ato fonde që janë miratuar Tetor –Dhjetor 2015 (të detajuara shif tabelat si më poshtë).
2. Ristrukturimi i territorial dhe zhvillimi i reformës administrative së njësisive të qeverisjes vendore, transferimi i kontratave në vazhdim nga Komunitat dhe bashkitë e vjetra tek Njësitë e reja të krijuara me reformën territoriale.
3. Projekte me cilësi të dobët të zhvilluara nga Njësitë e Qeverisjes Vendore për vitin 2015 (Bashkia Durrës , Bashkia Sarandë si dhe njësi të tjera).
4. Në kuadër të likuidimit të detyrimeve/ kontrata nga viti 2012-2013 nuk janë realizuar 100% pasi nga KZHR nuk janë miratuar vendimet për likuidimin e detyrimeve për kontratat që vijnë me detyrime nga vitit 2013.

Me Vendimin e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve Nr.44, datë 27.11.2015 “Për disa ndryshime te vendimeve të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve nr.11, date 25.02.2015, Nr.19, datë 16.3.2015 nr.28, date 29.05.2015, Nr.6, datë 10.06.2014, nr.11, datë 1.8.2014, si dhe nr.12, datë 25.02.2015” është miratuar për MAS lista e projekteve te reja 2015-2016, dhe eshte anuluar financimi per sa më poshtë:

Vendimi 48, datë 28.12.2015	Programi	Nr i projekteve te miratuara	Vlera e plote e projektit	Financimi 2015 miratuar , Vendimi Nr.48, datë 28.12.2015	Financimi i çelur/pakesuar ne MF per 2015
Shtese financimi	09120	12		145,678,304	145,678,304

Pakësim financimi	09120	4		(145,678,304)	(145,678,304)
Shtese financimi	09230	4		40,948,857	40,948,857
Pakësim financimi	09230	4		(40,948,857)	(40,948,857)
Shtese financimi	09450	1		5,000,000	5,000,000
Pakësim financimi	09450	1		(-5,000,000)	(-5,000,000)
Totali shtesave				191,627,161	191,627,161
Totali pakesimeve				(191,627,161)	(191,627,161)

Me Vendimin e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve Nr.48, datë 28.12.2015 “Për shpërndarjen e financimit për disa projekte të programit të arsimit, pjesë e Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, për vitin 2015, si dhe disa ndryshime në VKZHR nr.41, datë 16.10.2015” është miratuar për MAS financimi për listën e projekteve me cikël financimi 2012-2013, dhe është reduktuar financimi për projektet e reja të vitit 2015, për sa më poshtë:

Vendimi 48, datë 28.12.2015	Programi	Nr i projekteve të financuar	Vlera e plote e projektit	Financimi 2015 miratuar , Vendimi Nr.48, datë 28.12.2015	Financimi i celur në MF për 2015
Miratuar	09120	8	372,877,746	81,250,375	81,250,375
Miratuar	09230	7	544,149,756	127,517,703	127,517,703
Miratuar	09450	2	383,041,000	33,528,020	33,528,020
Reduktuar financimi	09120	1		(34,777,000)	(34,777,000)
Reduktuar financimi	09230	3		(45,301,000)	(45,301,000)
Totali shtesave			1,300,068,502	242,296,098	242,296,098
Totali pakesimeve				(80,078,000)	(80,078,000)

III - ARSIMI I MESËM I PËRGJITHSHËM. (Titulli i programit 09230);

Programi synon krijimin e shanseve të barabarta për të gjithë nxënësit për një arsim cilësor, masiv dhe bashkëkohor; mirë menaxhim të burimeve njerëzore; fuqizimin dhe rritjen e autonomisë shkollore; shtrirjen dhe zgjerimin e arsimit të mesëm të përgjithshëm; për rritjen e nivelit të arsimit të popullsisë, për ta përafëruar atë me standardet evropiane, për të përgatitur qytetarë më të aftë për një shoqëri demokratike.

Objektivat kryesore:

Objektiv 1). Rritja e mëtejshme e cilësisë së mësimdhënies, me qëllim që, deri në vitin 2018 të përafërohet me standardet e vendeve të BE Përmirësimi i standardeve të infrastrukturës në gjimnaze, 8-10% e klasave ndaj totalit ekzistues do të rehabilitohen, 5%-8% e klasave ndërtohen të reja, 8-10 % e shkollave do të pajisen me laborator shkencor

Objektiv 2). AMP ta ndjekin 75% e nxënësve që përfundojnë arsimin bazë, ndërsa 25% ndjekin arsimin profesional. Shtimi i laboratorëve të TIK si dhe shtrirja në vazhdim e internetit në shkollat e arsimit të mesëm të mesëm të përgjithshëm. Pajisja me laboratorë virtuale e rreth 15% të shkollave të mesme të përgjithshme për çdo vit. Pasurimi i bibliotekave në të gjitha shkollat.

Objektiv 3). Trajnimi i 10-15% e punonjësve mësimorë, për zbatimin e kurikulës së gjimnazit.

Objektiv 4). Krijimi i kushteve për realizimin e maturës shtetërore për afro 40-42 mijë maturanë, hartimi i testeve për provimeve, procesi i dhënies së provimeve, vlerësimeve të provimeve, deri në shpalljen e rezultateve.

Arritje 2015

Në vitin shkollor 2014/2015, rreth 93% e nxënësve që përfunduan arsimin e detyruar u regjistruan në arsimin e mesëm, çka tregon se objektivi i kësaj qeverie, sipas të cilit çdo nxënës që përfundon arsimin e detyruar duhet të ketë mundësi reale për të vijuar arsimin e mesëm, është realist dhe në rrugë të mbarë të realizimit të tij. Për vitin 2014-2015 në **arsimin e mesëm të përgjithshëm** u siguruan kushte dhe shërbime arsimore për rreth **115 799** nxënës nga 140,043 të regjistruar në arsimin e mesëm.

Numri i Nxënësve, Institucioneve dhe Mësuesve në Arsimin Parauniversitar, Viti Shkollor 2014-2015, Arsimit Publik dhe Privat							
Numri i Nxënësve, Institucioneve, Mësuesve dhe Përqindjet përkatëse sipas Niveleve të Arsimit							
	Gjithsej në Arsimin Parauniversitar	Arsimi Parashkollor (AP)	Përqindja Nx. AP / Gjithsej	Arsimi Bazë (AB)	Përqindja Nx. AB / Gjithsej	Arsimi i Mesëm (AM)	Përqindja Nx. AM / Gjithsej
Nr. i Nxënësve	585,945	82,494	14.08%	363,408	62.02%	140,043	23.90%

Nr. Institucio	3,569	1,857	48.88%	1,493	39.30%	497	13.08%
Nr. i Mësuesve	37,943	4,495	11.85%	24,777	65.30%	8,671	22.85%

- Në arsimin e mesëm të përgjithshëm, vazhdon konsolidimi i cilësisë së Maturës Shtetërore, e cila konsiston në 4 provime për rreth 42 - 45 mijë maturantë (2 provime të detyruara dhe 2 provime me zgjedhje). Matura shtetërore dhe provimet e liritimit 2015. Në tërësinë e organizimit dhe administrimit, Matura Shtetërore shënoi një standard të ri në realizimin e përgjegjësisë publike që Ministria e Arsimit dhe Sportit ka për cilësinë e shërbimit arsimor. MAS, ashtu siç ishte angazhuar dhe siç u kishte premtuar qytetarëve, arriti të realizojë Maturën Shtetërore si një maturë të besueshme.

Provimet e MSH, Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të arsimit parauniversitar sipas standardeve bashkëkohore të cilësisë.

Për vlerësimin e arritjeve të nxënësve sipas standardeve bashkëkohore të cilësisë, u pilotua testimi i nxënësve të klasës së tretë dhe të pestë sipas standardeve të PISA-s. Ky testim u krye me një kampionim prej 3,500 nxënësish për klasën e pestë dhe 3,537 nxënësish për klasën e tretë, i shtrirë në të gjithë vendin.

- U realizua Konferenca për prezantimin e raportit dhe të analizës së vlerësimit të kryer.
- U zhvilluan sesioni i parë dhe i dytë i provimeve të Maturës Shtetërore 2015.
- Në Maturën Shtetërore 2015 për provimin e Gjuhës Shqipe dhe Letërsi morën pjesë 39,910 maturantë, nga të cilët rezultuan kalues 97.25% e tyre.
- Për provimin e Matematikës morën pjesë 39,896 maturantë, nga të cilët rezultuan kalues 93.6% e tyre, ndërsa për provimet me zgjedhje morën pjesë 39,814 maturantë dhe kaluan 94.64%.
- Në mbyllje të Maturës Shtetërore 2015, u diplomuan 43,389 maturantë.
- U krye monitorimi i MSH gjatë provimeve dhe gjatë vlerësimit të testeve në qendrat e vlerësimit.
- Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit për ofrimin e testeve “APTIS for Teens” për arsimin baze dhe “TOEFL Junior” për Maturën Shtetërore.
- Zhvillimi i provimeve të Liritimit.
- Zhvillimi i olimpiadave kombëtare.

- Në kurrikulën e arsimit të mesëm të përgjithshëm është shtuar si lëndë me zgjedhje këtë vit, lënda “Financat Personale”, e cila realizohet në bashkëpunim me Bankën Qëndrore të Shqipërisë që ofron ekspertizën dhe trajnon mësuesit përkatës në shkollat e mesme. Është aktualisht në proces përgatitja e programit modular për lëndën e Sipërmarrjes përfshirë në kurrikulën me zgjedhje të arsimit të mesëm, në funksion të përgatitjes për tregun e punës.

- Shkolla Qendër Komunitare** “Shkolla qendër komunitare - një shkollë miqësore për të gjithë” është nismë që synon përmirësimin e cilësisë së punës dhe jetës në shkollë duke e kthyer atë në vendin ku ndërtohet partneriteti shkollë-familje-komunitet, përtej orëve të mësimi. Nisma, në vitin shkollor 2013-2014 u shtri në 66 shkolla në shkallë vendi – 35 në arsimin bazë dhe 31 në arsimin e mesëm dhe atë profesional. Nisma mbështetet mbi standarde të miratuara nga MAS. Ajo është e koordinuar në të gjitha nivelet. Nisma mbështetet nga institucione dhe organizata, partnerë të MAS në këtë nismë si Këshilli Europës, UNICEF, Korpusi Paqes, Eorl Vision, Fondi shqiptaro-amerikan për zhvillim, Save the Children, Këshilli Britanik, Terre Des Homme etj. DAR/ZA dhe shkollat pjesë të kësaj nisme për vitin shkollor 2013-2014 realizuan: Veprimtari në kuadrin e gjithëpërfshirjes në arsim, me komunitetin rom, fëmijët me aftësi të kufizuara, shërbim psikologjik.

- Veprimtari sportive të gjitha llojeve të sporteve në mjediset aktuale por dhe në veprimtari rajonale apo të pushtetit vendor. Veprimtari kulturore, artistike. Bibliotekat në funksion të të gjithëve Veprimtari për mbrojtjen e mjedisit

- Në këto veprimtari janë përfshirë një numër i konsiderueshëm nxënësish, mësuesish dhe prindërit. Tre qarqet që patën përfshirjen më të madhe në këtë nisim ishin;

Në vitin shkollor 2014-2015 u zgjerua numri i shkollave të përfshira në iniciativën Shkolla Qendra Komunitare, sot kemi 162 shkolla nga 150 të synuara si rezultat i rishikimit të hartës shkollore pjesëmarrëse në këtë nismë. Numri i shkollave është rritur përafërsisht në çdo DAR/ZA rreth 11 shkolla në total.

✚ **Mbështetje rajonale për arsimin gjithpërfshires**, në muajin shtator 2014 shkollave ju është shpërndarë udhëzuesi i përgatitur për këtë qëllim nga ekspertë të IZHA-s. 7 shkolla pjese e projektit rajonal “**Mbështetje rajonale për arsimin gjithpërfshires**” tashmë edhe pjese e këtij projekti kane përfituar grante shkollore nga Bashkimi Europian dhe Këshilli Evropës për projekte të hartuara në këtë fushe. Përmes këtij projekti një rëndësi përparësore do ti jepet arsimit të mesëm dhe atij profesional. U realizua financimi i mësuesve të cilët do të japin kontribut në këtë nisme.

✚ **Gjatë vitit 2015, Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP)** organizoi Provimin e Shtetit për degët Mjekësi dhe Farmaci etj, nëpërmjet teknologjisë dixhitale dhe në përputhje me standartet evropiane. Sesioni i parë i provimit të shtetit përfundoi me sukses të plotë dhe fitoi një besueshmëri të lartë tek publiku. Për herë të parë në Shqipëri u zhvillua dhe implementua një standard i mirëfilltë ndërkombëtar i provimit tërësisht dixhital, me zero korrupsion dhe transparencë maksimale.

✚ **Sfida kryesore në arsimin e mesëm të përgjithshëm vazhdon të mbetet cilësia me standarte bashkohore**, dhe përafrimi i kurrikulës së klasës 10-12 në përputhje me tregun e punës.

Buxheti i miratuar për programin e arsimit të mesëm të përgjithshëm për vitin 2015 është në vlerën 6 miliard e 878.9 milion lekë me 15.4% të buxhetit të MAS. Fondet e buxhetit të rishikuar për vitin 2015 arrijnë në vlerën 7 miliard e 122.4 milion lekë me 17.7% të buxhetit të MAS. Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2015 është në masën 6 miliard 976 milion lekë ose në 98% e fondeve të rishikuara të programit. Fondet e arsimit bazë zënë rreth 17.5% të totalit të shpenzimeve të realizuara për periudhën 12-mujore për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, si dhe 1.51% ndaj shpenzimeve publike dhe 0.48% ndaj PBB%.

a) **Fondet për shpenzime personeli, ku përfshihen pagat dhe sigurimet shoqërore, janë 5 miliard e 745.8 milion lekë për 7331 punonjës nga të cilët 6554 punonjës mësimorë/ në institucione arsimore dhe 787 punonjës ndihmës për shërbime mbështetëse, ku përfitues të shërbimit arsimor janë rreth 104 308 nxënës ve në arsimin e mesëm (gjimnazet) , realizimi 12-mujor është në masën 5 miliard e 734 milion lekë ose në masën 100%.**

Për vitin 2015 në programin e arsimit të mesëm, u siguruan kushte për kryerjen e praktikës profesionale për rreth 300-400 praktikantë konform Vendimit nr. 197, datë 4.3.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e numrit të praktikantëve “Për kryerjen e praktikës profesionale” me kontratë të përkohshme, për periudhën 1 janar deri 15 qershor dhe 15 shtator deri 31 dhjetor 2015, për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit”. Rregullorja mbi “Organizimin dhe Zhvillimin e Praktikave Profesionale për Profesionin e Rregulluar të Mësuesit” Nr. 3874, datë 14.07.2011 **miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit si dhe programi i praktikës profesionale për mësuesit e rinj**, të cilët do t’i nënshtrohen provimit të shtetit, në mënyrë që të kualifikohen si mësues të licencuar. Sipas kësaj Rregulloreje, mësuesit e diplomuar në shkollat tona të larta do të mundën ta ushtrojnë profesionin e mësuesit vetëm pasi t’i nënshtrohen praktikës profesionale njëvjeçare të cilët janë mësues që përmbushin kriteret e caktuara, dhe pasi t’i jenë nënshtruar provimit të shtetit.

Në vitin 2015, janë dhënë shpërblim për 1783 nxënës me 5 000 lekë duke përfituar rreth 8.9 milion lekë.

b) **Shpenzime operative në artikullin 602- 606, janë planifikuar 296.2 milion lekë ose 4.2% e shpenzimeve korente, buxhti i rishikuar së bashku me fondet e çelura për detyrime borxhe është në masën 376.8 milion lekë, realizimi i shpenzimeve për periudhën 12- mujore është në masën 315.2 milion lekë ose 83% ku përfshihen;**

- Shpenzime për DAR/ZA shpenzime për transportin e mësuesve dhe për blerje mjetet didaktike e materiale të tjera mësimore në vlerën **60 milion lekë**,
- Shpenzime për trajnime personeli e të ngjashme – **20 milion lekë**,
- Shpenzime për AKP - **119 milion lekë**, shpenzime për aktivitete për maturën shtetërore 2015, si dhe provimet e shtetit janë realizuar **115.6 milion lekë ose 97.2%** e fondeve të planifikuara .
- Shpenzime për blerje dokumentacion shkollor regjista, amza, deftesa, **0.8 milion lekë**, për vitin 2015
- Shpenzime për të mbuluar aktivitete ekstrakurrikulare, olimpiada kombëtare apo ndërkombëtare, konferenca në MAS, **2 milion lekë**

- **Shpenzime për në artikullin 606**, - Kompesimi i blerjes së teksteve shkollore për të gjithë nxënësit e familjeve që marrin ndihmë sociale **66 milion lekë**, përfitojnë ribursim rreth 15,890 nxënës.

c) **Fondet për investime kapitale në programin e Arsimit Mesëm të Përgjithshëm**, janë **miratuar 737 milion lekë lekë**, nga të cilat **537 milion lekë me financim të brendshëm** ose 72.8% dhe 200 milion lekë me financim të huaj ose 27.2%. Buxheti i rishikuar për këtë program është **987.3 milion lekë nga të cilat 914.5 milion lekë me financim të brendshëm ose 81.8% dhe 180 milion lekë me financim të huaj ose 18.2%.**

Realizimi i shpenzimeve kapitale për 12- mujorin 2015 në këtë program është 914.5 milion lekë ose 93%, sipas projekteve kryesore paraqiten:

1. **Në vitin 2015, janë financuar 39 objekte/projekte**, nga të cilat; për **ndërtime të reja, si dhe shtesa objektesh shkollore** janë 6 objekte/ projekte me vlerë të plotë 863.2 milion lekë dhe vlerë financimi të miratuar për vitin 2015 në shumën prej 216.1 milion lekë, realizuar për vitin 2015 në shumën prej 216 milion lekë ose 100%.
për **rikonstruksione të objekteve shkollore** janë 33 objekte/projekte me vlerë të plotë 1 miliard 154.3 milion lekë dhe vlerë financimi të miratuar për vitin 2015 në shumën prej 512.4 milion lekë, realizuar për vitin 2015 në shumën prej 460.4 milion lekë ose 90%.
2. **Janë financuar për pajisje mobilierie** për afro **33 objekte arsimore** që përfundojnë punimet në vitin 2015 me vlerë 35.9 milion lekë, janë realizuara 29.9 milion lekë ose në masën 83%.
3. **Blerja pajisje tableta dhe platforme e-learning** kredi me qeverinë austrië, financimi për blerjen e platformave e-learning si dhe pajisje me tableta për nxënësit e klasave të 10-11-12, të arsimit të mesëm gjimnazet me një fond janë miratuar me ligjin vjetor 160/2014 shuma prej **200 milion lekë** (Kredi e butë e Qeverisë Austrië në shumën prej 3.5 milion Euro, ratifikuar me ligjin nr. 79/2014 “Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë për eksport ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë dhe përfaqësohet nga Ministria e Financave, dhe Unicredit Bank Austria ag, lidhur me financimin e projektit “modernizimi i sistemit arsimor në Shqipëri nëpërmjet e-edukimit”. për vitin 2015 plani i rishikuar ishte 180 milion lekë janë realizuar pagesa prej 750,000 Euro ose rreth 173 milion lekë ose 93% e planit.
4. **Pajisje kompjuterike arsimi i mesëm i përgjithshëm** 21.6 milion lekë, janë realizuara me sukses procedura e prokurimit dhe është realizuar kontrata 21.6 milion lekë ose në masën 100%.

Buxheti i miratuar për programin e arsimit të mesëm të përgjithshëm për vitin 2015 është në vlerën **6 miliard e 878.9 milion lekë me 15.4%** të buxhetit të MAS. **Fondet e buxhetit të rishikuar** për vitin 2015 arrijnë në vlerën **7 miliard e 122.4 milion lekë me 17.7%** të buxhetit të MAS. Realizimi i fondeve për periudhën 12-mujore 2015 është në masën 6 miliard 906 milion lekë ose në 97% e fondeve të rishikuara të programit. Fondet e arsimit bazë zënë rreth 17.5% të totalit të shpenzimeve të realizuara për periudhën 12-mujore për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, **si dhe 1.51% ndaj shpenzimeve publike dhe 0.48% ndaj PBB%.**

Sipas grup artikujve të dhënat janë sa vijon;

Shpenzimet korente	99 %
<u>Shpenzimet kapitale</u>	<u>93 %</u>
Gjithsej	98 %

Në këtë program janë parashikuar për t'u realizuar produktet e mëposhtem, ecuria e të cileve krahasuar me planin vjetor paraqitet në tabelën në vijim:

Kodi i Produktit	Emri i Produktit	Buxheti Vjetor 2015	Buxheti Vjetor Rishikuar 2015	Fakti 12-mujor 2015	Realiz 12-mujor ne %
A	Shkolla ne arsimin e mesem te reabilituara/zgjeruara	250,000.0	515,362.4	462,516.6	90%
A	Shkolla te reja te ndertuara sipas standardeve europiane	216,923.0	216,923.0	215,675.0	99%
A	Pajisje me TABLETA dhe platforme e-learning per kabinetet e informatikes	200,000.0	180,000.0	173,239.0	96%
A	Laboratore IT te pajisura me kompjutera ne AMP.	22,869.0	21,599.0	21,599.0	0%
A	Shkolla/ klasa te pajisura me mobileri	30,000.0	35,920.0	29,861.0	83%

F	Laborator elektronike të pajisura me kompjutera, printues në AKP.	17,500.0	17,500.0	11,579.0	66%
A	Rritja e tërheqjes së nxënësve që mbarojnë arsimin bazë në gjimnaze, me synim që në vitin 2018 afro 65% e nxënësve që vijnë nga arsimi bazë të ndjekin arsimin e mesëm të përgjithshëm, ndërsa 35% do të ndjekin arsimin profesional.	5,964,461.0	5,868,481.4	5,808,819.7	99%
B	Trajnimi i 10-15% e punonjësve mësimore, për zbatimin kurikulës së gjimnazit	9,000.0	10,064.6	10,064.6	100%
C	Rishikimi i kurrikulave të Arsimit të Mesëm të Përgjithshëm. Realizimi i proceseve teknike dhe ligjore për hartimin e kurrikulave si dhe miratimi i ketyre standarteve dhe kurrikulave.	6,000.0	8,812.6	4,305.2	49%
D	Krijimi i kushteve për realizimin e matures shtetërore.	96,510.0	169,298.4	159,944.3	94%
E	Pajisja e 100 % të nxënësve me tekste mësimore në përputhje me kurikulat e reja dhe sipas standardeve europiane. Mbështetja e grupeve në nevojë duke rimbursuar 100% koston e teksteve shkollore nga buxheti i shtetit.	66,000.0	66,000.0	66,000.0	100%
	TOTALI	6,878,971.0	7,109,961.4	6,963,603.4	98%
	Shpenzime jashte buxhetore		12,465.7	12,465.7	100%
	TOTALI	6,878,971	7,122,427	6,976,069	98%

Nga tabela e mësipërme del që disa produkte nuk janë realizuar për 12-mujorit 2015;

1. **Procedura për blerje pajisje mobilierie** për Shkollën Koreografike Tiranë në shumën **6.1 milion objekte arsimore** nuk janë realizuar pasi kjo kontratë lidhet dhe me përfundimin e punimeve të rikonstruksionit, kontratë e cila nuk u realizua deri në datën 31.12.2015;
2. Nuk është realizuar me sukses procedura e prokurimit për lidhjen e kontratës së punimeve të rikonstruksionit **për Shkollën Koreografike Tiranë**, kontratë e cila nuk u është lidhur deri në datën 31.12.2015;
3. Nuk u realizua në masën 100% financimi i projektit “modernizimi i sistemit arsimor në Shqipëri nëpërmjet e-edukimit”, për vitin 2015 plani i rishikuar ishte 180 milion lekë u realizuar pagesa prej 1,250,000 Euro ose rreth 173 milion lekë ose 96% e planit.

Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit për 12- mujorin 2015:

1. Vendimarrja me vonesë e komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, për fondet e zhvillimit të rajoneve 2015, Vendimin e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve Nr.44, datë 27.11.2015 “Për disa ndryshime të vendimeve të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve nr.11, date 25.02.2015, Nr.19, datë 16.3.2015 nr.28, date 29.05.2015, Nr.6, datë 10.06.2014, nr.11, datë 1.8.2014, si dhe nr.12, datë 25.02.2015” është miratuar për MAS lista e projekteve të reja 2015-2016, dhe është anuluar financimi për sa më poshtë:

Vendimi 48, datë 28.12.2015	Programi	Nr i projekteve të miratuara	Vlera e plote e projektit	Financimi 2015 miratuar , Vendimi Nr.48, datë 28.12.2015	Financimi i çelur/pakesuar ne MF per 2015
Shtese financimi	09230	4		40,948,857	40,948,857
Pakësim financimi	09230	4		(40,948,857)	(40,948,857)

2. Ristrukturimi i territorial dhe zhvillimi i reformës administrative së njësive të qeverisjes vendore, transferimi i kontratave në vazhdim nga Komunitat dhe bashkitë e vjetra tek njësitet e reja (bashkitë e reja) të krijuara me reformën teritoriale, kanë ndikuar në ecurinë e realizimit të kontratave.
3. Projekte të zhvilluara me cilësi të dobët nga Njësitet e Qeverisjes Vendore për vitin 2015 ose që kanë pasur nevojë për rishikim të standardeve (Bashkia Durrës, Bashkia Sarandë si dhe njësi të tjera).
4. Nuk janë realizuar/ likuiduar 100% detyrimet financiare të kontratave nga viti 2012-2013 të cilat ishin parashikuar të likuidohen me buxhetin e vitit 2015, pasi nga KZHR nuk janë miratuar vendimet për likuidimin e detyrimeve për kontratat e vitit 2013.
5. Me Vendimin e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve Nr.48, datë 28.12.2015 “Për shpërndarjen e financimit për disa projekte të programit të arsimit, pjesë e Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, për vitin 2015, si dhe disa ndryshime në VKZHR nr.41, date 16.10.2015” është miratuar për MAS financimi për listën e projekteve me cikël financimi 2012-2013, dhe është reduktuar financimi për projektet e reja të vitit 2015, për sa më poshtë:

Vendimi 48, datë 28.12.2015	Programi	Nr i projekteve të financuar	Vlera e plote e projektit	Financimi 2015 miratuar , Vendimi Nr.48, datë 28.12.2015	Financimi i çelur ne MF per 2015
Miratuar	09230	7	544,149,756	127,517,703	127,517,703
Reduktuar financimi	09230	3		(45,301,000)	(45,301,000)

V - INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË. (Titulli i programit 09450)

Objektivat kryesorë;

Objektiv 1. Akreditimi institucional i IAL dhe kontraktimi i nje agjencie të huaj për këtë qëllim. Reformatim i mekanizmeve të kontrollit të cilësisë rishikim i standarteve shtetërore të cilësisë konform atyre të HEAL, rivlerësim i KSHK kundrejt KEK dhe problematikave të hasura deri tani si dhe duke mundësuar lidhjen e kualifikimeve me tregun e punës.

Objektiv 2. Rritja e kapaciteteve në staf akademik dhe infrastrukture të IAL, rritjen e numrit të pedagogëve me 800, rritjen e numrit të laboratoreve shkencore dhe/ose përmirësimin dhe zgjerimin e tyre, përmirësim i infrastruktures ekzistuese të IAL dhe ngritja e godinave të reja, rritja e aksesit në bibliotekat dhe revistat online dhe krijimi i një rrjeti bibliotekash shkencore dhe hartimi i nevojave reale për keto komponente. Përmirësim i infrastruktures ekzistuese të IAL dhe ngritja e godinave të reja rritja e aksesit në bibliotekat dhe revistat online dhe krijimi i një rrjeti bibliotekash shkencore

Objektiv 3. Përgatitja e kuadrit nënligjor për reformimin e kurrikulave në AL si dhe mundësimi nga ana ligjore i financimeve/bursave për doktorantet nga sistemi privat, rishikim i skemës së promovimit për tituj e grada konform praktikave përëndimore duke i dhënë rendesi pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare.

Objektiv 4. Krijimi i regjistrit elektronik kombëtar të diplomave universitare për të rritur transparencën dhe ulur korrupsionin si dhe një databazë kombëtare për regjistrin e studentëve, të dhënat e karrierës akademike, diplomimit, provimet e shtetit, të dhënat e stafit akademik, etj . Hartim i kuadrit ligjor përkatës dhe fillimi i implementimit të projektit. Ndërtimi i instrumentave të llogaridhënies publike të universiteteve dhe transparencës në linjë me rritjen e autonomisë.

Objektiv 5. Ndërtimi i kuadrit ligjor që mundëson lehtësira fiskale për subjektet fizike dhe juridike që financojnë me bursa për të gjitha ciklet e studimit studentët sidomos ato të kategorive në nevojë apo fonde për kërkim shkencor, dhe fillimi i implementimit.

Objektiv 6. Ngritja e institucioneve të reja në strukturën e arsimit të lartë në RSH; fillimi i implementimit të skemës së re të pranimit në IAL, fillimi i implementimit të statusit të ri të IAL-ve dhe vendosja e prioritetëve kombëtare për pranimin e studentëve. Rishikim i standarteve shtetërore të cilësisë konform atyre të HEAL. Rivlerësim i KSHK kundrejt KEK lidhja e kualifikimeve me tregun e punës. Implementimi në formatimin e programeve të studimit dhe sipas kërkesave të tregut të punës Diversifikim të burimeve të financimit, me qëllim optimizimin e investimit publik dhe privat në AL, në funksion të arritjes së objektivave të përgjithshme të AL. Implementimi i kuadrit ligjor dhe institucional e reformës financiare në AL.

Objektiv 7. Realizimi i politikave të përfshirjes sociale dhe aksesit të gjërë në AL nëpërmjet skemës së kredidhënies studentore dhe mbështetjes financiare për përmirësimin e kushteve në shtëpitë e studentëve, heqjen e barrierave arkitektonike në IAL, përfshirjen e kategorive të tjera të vecanta në kuotat e parashikuara për keto kategori.

8) Mbështetje e mobilitetit dhe internacionalizimit të arsimit të lartë.

Arritje në vitin akademik 2015

Për vitin akademik, 2015-2016, numri i pranimeve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë ka shënuar një rritje të pranimeve, ndaj studentëve që janë regjistruar dhe ndjekur studimet për vitin akademik 2014-2015.

Gjatë vitit ka një risi në politikëbërje përmes një procesi të veçantë që u realizua për Reformën e Arsimit të Lartë. Pas miratimit të ligjit të ri të arsimit të lartë, Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, kemi tashmë gati një reformë tërësore të sistemit të arsimit të lartë, e cila synon rritjen e cilësisë në të gjithë sistemin, pa cenuar aspak mundësitë e të rinjve për t’u arsimuar.

1) VKM nr. 638, datë 22.08.2015 “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në

programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2015-2016”, i ndryshuar;

- 2) VKM nr. 808, datë 3.10.2015 “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2015-2016”;
- 3) Udhëzimi Nr. 24, datë 31.07.2015 “Për zhvillimin e konkurseve të pranimit dhe tarifën e regjistrimit për konkurrim në disa programe studimi të ciklit të parë me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2015-2016”, ndryshuar;
- 4) Udhëzimi Nr. 26, datë 18.08.2015 “Për procedurat e pranimit dhe regjistrimin për kandidatët nga Republika e Kosovës, si dhe kandidatët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2015-2016”, i ndryshuar;
- 5) Udhëzimi Nr. 29, datë 21.08.2015 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe regjistrimit për kandidatët me statusin e të verbërit, të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të jetimit, si dhe romët dhe ballkano-egjiptianët, në programet e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet publike të arsimit të lartë”;

✚ Janë ndërmarrë hapat e duhur në rrugën e kthimit të autoritetit të ligjit në institucionet e arsimit të lartë dhe në drejtim të frenimit të rrënimit të arsimit të lartë, si çelës i kthimit të besimit të publikut në IAL-të shqiptare, duke iniciuar procesin e Verifikimit të Kushteve të Ligjshmërisë në të gjitha IAL-të shqiptare, publike dhe private.

- 1) Urdhri nr. 498, datë 31.12.2014 “Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e respektimit të kriterëve dhe procedurave lidhur me zhvillimit e provimit të datës 07.02.2014 pranë Fakultetit të Muzikës, Universiteti i Arteve, Tiranë”;
- 2) Urdhër nr. 63, datë 11.02.2015 “Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin dhe respektimin e kriterëve dhe procedurave të ndjekura nga Universiteti i Sporteve, Tiranë, në përzgjedhjen e kandidatëve të ciklit të tretë të studimeve të doktoratës, viti akademik 2012-2013, si dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi për këtë cikël studimi”;
- 3) Urdhër nr. 59, datë 08.02.2016 “Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e zbatimit të kuadrit ligjor e nënligjor për pranimet dhe ecurinë në ciklin e tretë të studimeve të doktoratës, në Akademinë e Forcave të Armatosura”;
- 4) Urdhri nr. 453, datë 24.11.2015 “Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e kontrollit të ligjshmërisë në respektimin e kriterëve dhe procedurave në rekrutimin e stafit akademik në Fakultetin Ekonomik, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, për vitin 2015”;
- 5) Urdhri nr. 134, datë 03.04.2015 “Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e zbatimit të kuadrit ligjor e nënligjor për pranimet, ecurinë dhe diplomimet në ciklin e tretë të studimeve të doktoratës, rekrutimin e personelit akademik, promovimin për tituj akademikë dhe funksionimin e organeve kolegjiale, si dhe zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi lidhur me kuotat dhe tarifat e studimit, në Qendrën e Studimeve Albanologjike”;
- 6) Urdhri nr. 495, datë 31.12.2015 “Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e respektimit të kriterëve dhe procedurave për promovimin e titujve akademikë për periudhën nga 01 Janar 2014 e në vijim”;
- 7) Urdhri e përbashkët nr. 467, datë 07.12.2015 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrit të Shëndetësisë “Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e dokumentacionit të kandidatëve të regjistruar për provimin e shtetit në profesionet e rregulluara në fushën e mjekësisë pranë Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë, Urdhrit të Stomatologut, Urdhrit të Farmacistëve të Shqipërisë dhe Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë për periudhën nga 01.01.2014 e në vijim”.

✚ Është realizuar vlerësimin paraprak dhe fillojmë punën për akreditimin e të gjitha IAL-ve me një agjenci britanike anëtare e ENQAS. Sistemi i sigurimit të cilësisë në AL është fuqizuar dukshëm.

- Anëtarësimi i Shqipërisë në Regjistrimit të Sigurimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë (EQAR - European Quality Assurance Register for Higher Education);

- Në Kuadër të Bologna Folloë Up Group (BFUG), së bashku me Rumaninë drejtojmë Grupin e punës për rishikimin e Supplementit të Diplomës;
- Pjesëmarrje në aktivitetet mbi arsimin e lartë në kuadër të BFUG dhe projekte dhe takime të tjera.
- Organizimi i Konferencës me temë: "Reforma e Arsimit të Lartë në Shqipëri: Realizimi i Shërbimeve Universitare - Eksperienca dhe Modeli Italian";

✚ Angazhimi i ekspertëve të huaj si vlerësues në terren dhe si antarë të Këshillit të Akreditimit ishte një hap shumë i rëndësishëm për fuqizimin e Agjencisë dhe Këshillit të Akreditimit dhe njohjen e tyre të plotë nga Strukturat internacionale të sigurimit të cilësisë. Gjithashtu janë fuqizuar njësitë e mbikqyrjes së cilësisë dhe inspektimit brenda MAS dhe në APAAL. IKAP, në vitin e dytë të veprimtarisë së tij, shënoi hapa të rëndësishme të konsolidimit të tij.

- Hapja e “Kolegjit Profesional të Tiranës”; Vendimi nr. 699, datë 26.08.2015 i Këshillit të Ministrave “Për licencimin e institucionit të arsimit të lartë, privat, me statusin e kolegjit profesional, “Kolegji Profesional i Tiranës”, Tiranë
- Akreditimi i 2 institucioneve të arsimit të lartë (Universiteti i Neë York-ut në Tiranë; Shkolla e Lartë Universitare, Jopublike “Eisdor University”; Urdhri nr. 405, datë 28.10.2015 “Për akreditimin institucional të Universitetit të Neë York-ut në Tiranë”;
- Akreditim i 31 programeve të studimi, Urdhri nr. 355, datë 25.09.2015 Përgatitja e urdhrave përkatës për akreditimin e 31 programeve të studimit.

✚ Janë mbështetur financiarisht studentëve, personelit akademik, si dhe punonjës të administratës publike, për të studiuar jashtë vendit.

- Nënshkrimi i aktmarrëveshjeve me 27 kandidatë fitues, (17 kandidatë që mbështeten për herë të parë dhe 10 kandidatë për vazhdim studimesh).
- Janë realizuar bursat dhe të drejtat e studimit në nivel universitar dhe pasuniversitar në kuadër të bashkëpunimit dy- dhe shumëpalësh arsimor dhe shkencor, si dhe të programeve të mobilitetit sipas marrëveshjeve me Francën, Çekinë (4 bursa master), Sllovakinë (4 bursa universitare dhe 1 pasuniversitare), Hungarinë (20 bursa studimi), Poloninë (12 të drejta studimi), Rusinë (37 bursa universitare/pasuniversitare), Rumaninë, Bullgarinë (3 bursa vere), Egjiptin (5 bursa universitare dhe 4 bursa pasuniversitare, Turqinë, Greqinë, Italinë (54 muaj bursa universitare), Egjiptin (5 bursa universitare dhe 4 bursa pasuniversitare), Kinën (3 bursa për studime universitare/pasuniversitare, Japoninë (1 bursë pasuniversitare), EBA (10 bursa master/Phd për energjinë e ripërtëritshme), VISEGRAD, CEEPUS.
- Realizimi i kursit të verës të gjuhës shqipe me pjesëmarrjen e 45 shtetasve të huaj, 1-30 shtator 2015.
- Hartimi i udhëzimeve të Ministrisë për pranimin e shtetasve të huaj për studime në ciklin e parë dhe të dytë në IAL shqiptare, ndjekja e procedurave për regjistrimin e shtetasve të huaj në IAL shqiptare (6 shtetas të huaj).
- Mbikëqyrja dhe vijimi i projektit pilot për mësimdhënien e gjuhës kineze në arsimin parauniversitar. Aktualisht janë 2 mësues kinezë për mësimdhënien e gjuhës kineze në 4 shkolla.
- Gjatë vitit 2014-2015, në kuadër të marrëveshjeve bilaterale e shkëmbimit të studentëve e kërkuesve të rinj është realizuar regjistrimi i 6 studentëve kinezë pranë Fakultetit Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës dhe trajtimit të tyre me bursë, viti akademik 2013-2014 dhe 2014-2015;

✚ **Gjatë vitit 2015**, Ministria e Arsimit dhe Sportit në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, Fakultetin Histori-Filologji, në zbatim të marrëveshjeve dypalëshe me shtete të ndryshme organizimi i kursit të verës të gjuhës dhe kulturës shqipe, ku marrin pjesë studentë dhe pedagogë të huaj rreth 30 studentë nga Fedarata Ruse.

✚ **Gjatë vitit 2015 nga sektori janë proceduar rreth 1200 diploma universitare të lëshuar jashtë vendit, përfunduar procedura e njohjes dhe njësimit për 914 diploma ndërsa rreth 286 të tjera janë në proces njohjeje.**

Dhënie e informacionit rrjetit european të njohjeve të diplomave dhe informacionit (ENIC-NARIC) dhe institucioneve të tjera brenda vendit, mbi diplomat e lëshuara në Republikën e Shqipërisë, autenticitetin dhe vlefshmërinë e tyre.

Gjatë vitit 2015 janë shqyrtuar;

Për vlerësimin e jashtëm dhe akreditimin; Vlerësimi i jashtëm institucional 7, vlerësimi i jashtëm i programeve të ciklit të parë 20, vlerësimi i jashtëm i programeve të ciklit të dytë 27, vlerësimi i jashtëm i programeve të ciklit të tretë 9.

Për vlerësimin paraprak të programeve të reja të studimit: vlerësimi paraprak i programeve të ri të studimit dyvjeçar 11, vlerësimi paraprak i programeve të studimit të ciklit të parë 7, vlerësimi paraprak i programeve të studimit të ciklit të dytë 38, vlerësimi paraprak i programeve të studimit të ciklit të tretë 0,

Vlerësimin e dokumentacionit për hapjen e njësive: Hapje kolegji 1, riorganizim fakulteti;

Vlerësimi i programeve të studimit pas plotësimit të kushteve: Vlerësimi paraprak i programeve të ri të studimit dyvjeçar 0, Vlerësimi paraprak i programeve të studimit të ciklit të parë 0, Vlerësimi paraprak i programeve të studimit të ciklit të dytë 4.

Gjatë vitit 2015 APAAL janë aktivizuar ekspertë vendas të kualifikuar akademikë për vlerësimin e programeve të studimit në arsimin e lartë. Janë bërë pagesat:

Për vlerësimin paraprak të programeve të studimit:

Vlerësimi paraprak i programit të studimit dy vjeçar jouniversitar	9 ekspertë;
Programe të ciklit të parë (Bsc)	5 ekspertë
Programe të ciklit të dytë	
Master professional	9 ekspertë
Master i shkencave	10 ekspertë
Master i shkencave (program i integruar 5-6 vjeçar)	1 ekspert

Për vlerësimin e jashtëm të programeve të studimit (Akreditim):

Programi i studimit dyvjeçar jouniversitar	1 ekspertë
Programe studimi të ciklit të parë (Bsc)	26 ekspertë
Program studimi të ciklit të dytë “	
Mp	5 ekspertë
Msc.	20 ekspertë
Msc integruar	5 ekspertë
Programi i studimit të ciklit të tretë	
(MND)	1 ekspertë
Dr.	1 ekspertë

Janë aktivizuar ekspertë të huaj për vlerësimin e jashtëm institucional të IAL dhe te programeve të studimit të ciklit të tretë. Janë bërë pagesat:

Për vlerësimin institucional të IAL	2 ekspertë
Për vlerësimin periodik institucional të IAL	2 ekspertë
Për vlerësimin e programeve të studimit të ciklit të tretë, Dr.	7 ekspertë

Në Agjencinë Kombëtare të Provimeve është ndërtuar Baza Elektronike e të dhënave të arsimit të lartë, që përfshin *Regjistrin Kombëtar të Studentëve*, ku çdo student i regjistruar në cdo shkollë të lartë, publike apo private, duke filluar që nga viti akademik 2011-2012, në të tri ciklet e studimeve universitare do të ketë numrin kombëtar të identifikimit, përveç atij që ka marrë në universitetin ku studjon

Fondet buxhetore të planifikuara në programin e arsimit të lartë për vitin 2015 janë **5 miliard e 797.6 milion** lekë, buxheti i rishikuar për vitin 2015 është në masën **5 miliard 903 milion lekë me 14.7%** të fondeve të rishikuara për MAS. Realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2015 në këtë program është në shumën **5 miliard e 783 milion lekë ose 98 %** e shpenzimeve të planifikuara. Shpenzimet e buxhetit të arsimit të lartë zënë 14.7% të buxheti të MAS dhe 17.5 % të shpenzimeve të realizuara të MAS.

Së bashku me të ardhurat në IAL publike realizimi arrin në vlerën e në **9.5 miliard lekë** ose 21.7% të fondeve për MAS, realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2015 është **9.35 miliard lekë ose në masën 98%**. Shpenzimet e buxhetit të arsimit të lartë së bashku me të ardhurat dytësore zënë 21.7 %, të shpenzimeve të realizuara të MAS

Për vitin 2015 fondet e buxheti janë detajuar në 13 Universitete dhe shkolla të tjera të larta, dhe tre institucione të sistemit të arsimit të lartë. Këto fonde kanë mbuluar shpenzimet për rreth 140 mijë studentë, që ndjekin studimet në tre cikle studimi në drejtime të ndryshme studimi.

Buxheti i shpenzimet korrente për vitin 2015, i planifikuara së bashku me të ardhurat e IAL në shumën 8 miliard e 618.4 milion lekë për periudhën 12- mujore është realizuar në masën 8 miliard 528 milion lekë 99%

✚ **Shpenzimet për zërin “pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve në artikullin 600/601”** janë planifikuara **4 miliard 505.9 milion lekë** për punonjësit e 13 Universitete dhe shkolla të tjera të larta, Agjensinë e Akreditimit Tiranë, si dhe Qendrën e Shërbimeve të Rrjetit Telematik Tiranë, realizimi i fondeve me burim nga buxheti i shtetit është realizuar **4 miliard e 486.8 milion lekë** ose 100% së bashku me të ardhurat e realizuara nga IAL publike arrin në shumën 6 miliard e 300.9 milion lekë realizimi për periudhën 12-mujore është në masën **6 miliard 281.9 milion lekë 100 %**.

✚ **Fondet për universitetet janë rialokuar në formën e grantit të pakushtëzuar.** Universitetet nëpërmjet organeve kolegjiale detajojnë këtë grant sipas njësive shpenzuese dhe zërave përkatës të buxhetit për shpenzime personeli paga dhe sigurimet shoqërore të punonjësve **4 miliard 450 milion lekë** ose rreth **100%** e transfertës së pakushtëzuar, realizimi i tyre është në masën 4 miliard e 450 milion lekëve ose 100% ndaj planit 2015.

✚ **Shpenzimet operative** artikulli **602-606**, ku përfshihen shpenzimet e funksionimit janë **893.8 milion lekë** dhe realizimi është në masën 830.3 milion lekë ose 86%, së bashku me të ardhurat e realizuara nga IAL publike arrin në shumën 2 miliard e 317.5 milion lekë realizimi për periudhën 12-mujore është në masën **2 miliard 246.9 milion lekë 97 %**.

✚ **Shpenzimet për artikullin 603. Subvencionet** të Sh.a “Trajtimi i Studentëve” në Tiranë dhe në rrethe janë **350 milion lekë** për akomodimin 10,000 studentë që akomodohen në mjediset shtëpive të studentëve, realizimi është në masën **350 milion lekë ose 100 %**.

✚ **Shpenzimet për zërin “Bursat e studentëve në artikullin 606”, janë planifikuara** 417 milion lekë për rreth 8 000 studentë që trajtohen me bursë nga IAL publike realizimi 12- mujor është në masën 360 milion lekë ose **86%**, së bashku me të ardhurat e realizuara nga IAL publike arrin në shumën 454.7 milion lekë realizimi për periudhën 12-mujore është në masën **396.4 milion lekë ose në masën 87 %**.

✚ **Fondet për investime kapitale në programin arsimit të lartë**, janë miratuar 442 milion lekë, nga të cilat me financim të brendshëm janë 242 milion lekë, si dhe financim të huaj në shumën 200 milion lekë, buxheti i rishikuar për vitin 2015 është 504 milion lekë, nga të cilat me financim të brendshëm janë 289 milion lekë, si dhe financim të huaj në shumën 215 milion lekë, së bashku me të ardhurat buxheti i rishikuar për vitin 2015 është 925.1 milion lekë. Realizimi i shpenzimeve kapitale për 12- mujorin 2015 në këtë program është 465 milion lekë ose 92 %, së bashku me të ardhurat e realizuara nga IAL publike arrin në shumën 925.2 milion lekë dhe realizimi për periudhën 12-mujore është në masën **816 milion lekë 88 %**.

d) sipas projekteve kryesore paraqiten:

- **Përmirësim i infrastrukturës ekzistuese të IAL dhe ngritja e godinave të reja**, Janë financuar 7 objekte/projekte, ndërtime të reja, si dhe shtesa objekteve shkollë në vazhdim nga viti 2012-2013 si dhe të miratuara në FZHR 2015 me vlerë financimi **219.8 milion lekë**, realizimi 12- mujor është 219.1 milion lekë ose në masën 100%.

- **Krijimi i infrastruktures kerkimore shkencore nepermjet projekteve Programe TEMPUS , Erasmus +**, blerje pajisje për ngritjen dhe ristrukturimin e laboratoreve kërkimore - shkencore dhe/ose përmirësimin dhe zgjerimin e tyre për ngritjen e Laboratoreve IT si dhe bibliotekave dixhitale për rritjen e cilësisë së mesimdhënis dhe kerkimit shkencor në IAL me 40 milion lekë realizimi në masën 60.2 milion lekë .
- **Blerje pajisje për ngritjen dhe ristrukturimin e laboratoreve kërkimore - shkencore dhe/ose përmirësimin dhe zgjerimin e tyre për ngritjen e Laboratoreve IT s për rritjen e cilësisë së mesimdhënis dhe kerkimit shkencor në IAL me 4.9 milion lekë realizimi në masën 4.5 milion lekë ose 100%.**
- **Përgatitja e regjistri elektronik kombëtar të diplomave universitare në bashkëpunim me RASH**, fondi i rishikuar për vitin 2015 është 36.3 milion lekë, realizimi në masën 33.2 milion lekë ose 92% (këto fonde janë pjesë e “Financimit të Huaj”,
- **Krijimi dhe funksionimi i Qëndres Ndëruniversitare e Shërbimeve të Rrjetit Telematik** “Projekti me qeverinë italiane për krijimin e qendrës informacionit kërkimit dhe zhvillimit, (Qeveria Italiane) fondi i rishikuar për vitin 2015 është 175 milion lekë, realizimi në masën 123.5 milion lekë ose 73% (këto fonde janë pjesë e “Financimit të Huaj”,

Në këtë program janë parashikuar për t’u realizuar produktet e mëposhtem, ecuria e të cileve krahasuar me planin vjetor jepet në tabelë:

Kod Produkt	Emri i Produktit	Buxheti Plan 2015	Buxheti i Rishikuar 2015	Fakti 12-mujor 2015	Realizimi % ndaj planit vjetor 2015
A	Përmirësimi i cilësisë së mesimdhënis për arritjen e standardeve të OECD, matur kjo me raportin student/pedagog	4,187,335	4,552,545	4,540,224.1	99.7%
B	Akreditimi institucional i IAL dhe kontraktimi i nje agjencie te huaj per kete qellim. Reformatm i mekanizmave te kontrollit te cilesise	22,617	22,617	16,797	74.3%
C	Realizimi i politikave të përfshirjes sociale mbështetjes financiare për përmirësimin e kushteve në shtëpitë e studentëve.	350,000	350,000.0	350,000.0	100.0%
D	Rritja e kapaciteteve në staf dhe infrastrukture të IAL si dhe i nevojave të tregut të punës	320,000	35,000	33,329	95.2%
E	Zhvillimi dhe implementimi i regjistri elektronik kombëtar të diplomave universitare në bashkëpunim me RASH .	27,138	17,139	15,015	87.6%
G	Realizimi i politikave të përfshirjes sociale dhe aksesit të gjërë në AL	410,000	417,733	359,434	86.0%
L	Ndërtimi i instrumentave të llogaridhënis publike të universiteteve dhe transparencës në linjë me rritjen e autonomisë	38,500	4,500	2,244	49.9%
L	Ndërtimi i regjistri elektronik kombëtar të diplomave universitare në bashkëpunim me RASH	68,004	36,285	33,193	91.5%
I	Krijimi dhe funksionimi i Qëndres Ndëruniversitare e Shërbimeve të Rrjetit Telematik.	100,000	175,000	127,473	72.8%
J	Përmirësimi i infrastruktures së IAL, Ndërtimi i reja si dhe rikonstruksion i mjediseve aktuale në IAL publike.	273,996	252,662	245,127	97.0%
K	Krijimi i infrastruktures kerkimore shkencore nepermjet projekteve Programe TEMPUS , Erasmus +, etj për ngritjen e Laboratoreve IT si dhe bibliotekave dixhitale për rritjen e cilësisë së mesimdhënis dhe kerkimit shkencor në IAL	-	40,000	60,203	150.5%
	TOTALI	5,797,590	5,903,480	5,783,038	98.0%
	Jashte buxhetore	0	3,640,049	3,561,546	97.8%
	TOTALI	5,797,590	9,543,529	9,344,584	97.9%

Nga tabela e mësipërme evidentohet se disa produkte nuk janë realizuar;

1. Krijimi i laboratoreve të Informatikës IT, si rrjeti i telematik ndëruniversitar.(procedurat janë në vijim, nuk është realizuar pagesa e parashikuar TVSH për vitin 2015, pasi pajisjet dhe softet e transferuara nga pala italiane ende nuk kanë kaluar përfundimisht në proësi të palës shqiptare për Qendrën e Rrjetit Telematik të IAL)

Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit për 12- mujorin e vitit 2015:

1. Ndryshimi me VKM i mjediseve të Projektit për ngritjen dhe zhvillimin Qendrën e Rrjetit Telematik të IAL, investim i Qeverisë Italiane, administrimi dhe menaxhimi i fondeve me financim të huaj që realizohet nga QNRRTSH, ka sjellë pasojë për mosrealizimin.
2. Mosçelja e fondeve nga Komiteti i zhvillimit të Rajoneve, ka penguar realizimin në tërësi të gjithë projektit, sipas afateve të përcaktuara në kontratat e investimeve në Universitetin Politeknik të Tiranës si dhe universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës.

VI - Kërkimi Shkencor. (Titulli buxhetor i programit 09770)

Programi për Kërkimin Fondamental dhe Fondin e Ekselencës synon të mbështesë kërkimin shkencor sipas prioritetëve kombëtarë të zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe kulturor të vendit, si dhe tendencave të zhvillimeve globale në shërbim të IAL-ve e komunitetit shkencor. Në këtë kuadër kërkohet që puna kërkimore-shkencore të vihet në funksion të zgjidhjes së problemeve dhe ofrimit të alternativave për zhvillimin e vendit.

Fondet për këtë program janë planifikuar në total në vlerën **177 milion lekë, buxheti i rishikuar për vitin 2015 arriti në masën 183.3 milion lekë, së bashku me të ardhurat e realizuara nga IAL publike si dhe projektet donatore arriti në 315.2 milion lekë, realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2015 në këtë program është 299.8 milion lekë ose 95%** dhe përfaqëson rreth 0.7 % të shpenzimeve të realizuara për 12- mujorin e vitit 2015 të fondeve buxhetit të MAS, krahasuar me shpenzimet publike fondet për arsimin për vitin 2015 arrijnë në **0.07%** dhe ndaj produktit të brendshëm bruto për vitin 2015 janë në nivelin **0.02%**.

Objektivat kryesorë

- 1) Rritja dhe zgjerimi i kërkimit shkencor në Shqipëri bazuar në treguesit e OECD; ku pjesa e shpenzimeve publike në vitin 2015 të arrijë 0,04 % të GDP (e përllogaritur për IAL publike e private, ministritë e linjës, institucione të tjera kërkimore shtetërore, Akademia e Shkencave si dhe nga bizneset), Përgatitja e Strategjisë së re për Kërkimin Shkencor 2015-2020.
- 2) Nxitja e punës kërkimore në IAL publike nëpërmjet financimit të drejtpërdrejtë të 3 200 kërkuesve, **ku prioritet kanë femrat**, si dhe mbështetje financiare për kërkim fondamental në IAL publike me fonde nga buxheti i shtetit, mbështetje financiare për funksionim e mirëmbajtjen e laboratorëve didaktiko -kërkimorë në IAL publike. Aplikime dhe propozime projektesh për ngritjen e Qendrave të Ekselencës (përfshi të ardhurat e IAL publike dhe Private).
- 3) Vlerësim të Kërkimit Shkencor në Shqipëri si dhe akreditimit të institucioneve dhe programeve të kërkimit (numri i programeve të vlerësuara do të rritet me 40 % në 2020 krahasuar me 2013).
- 4) Zgjerimi i bashkëpunimit të Universiteteve me biznesin privat në Programet Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit nëpërmjet organizimit të seminareve dhe takimeve informuese në IAL mbi Programet Kombëtare dhe Ndërkombëtare.
- 5) Pjesëmarrja në programin Horizon 2020, program për Kërkimin dhe Inovacionin (2014 - 2020). "Horizon 2020" do të bashkojë kërkimin me inovacionin dhe do të ketë një akses më të thjeshtë se programet paraardhëse për kompanitë dhe universitetet. "Horizon 2020" do të ketë tri shtylla kryesore: i) Shkencë - Ekselence, ii) Lideritet industrial, iii) Sfidat shoqërore. Finalizimi i marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe në fushën e kërkimit dhe teknologjisë.
- 6) Reformim i konceptit të Fondit të Ekselencës, me qëllim rritjen e efektivitetit të financimit dhe rikthimin e shpejtë të përfitimit të Shqipërisë, dhe të Brain Gain duke ndryshuar konceptin në Brain Circulation për të mundësuar kontributin e një kategorie më të gjerë profesionistësh për vendin. Mbështetja financiare për 50 studentet në 15 universitetet me të mira të botës (Lista FT) dhe doktorantë ekselentë, si dhe ekselentë apo të punësuar në kuadër të programit "Brain Gain".

Projekte që mbështeten me financim nga buxheti i shtetit si dhe nga marrëveshjet bilaterale e multilaterale për vitin 2015;

- ✚ Promovimi i Programeve Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit, nëpërmjet Konferencave dhe Seminareve të organizuara nga MAS si dhe IAL publike.
- ✚ Për vitin akademik 2014-2015, aplikuan pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, **7 aplikantë të ndërmjetëm (të cilët janë shpallur fitues në vitet akademike paraardhëse)**, për vazhdimin e mbështetjes financiare për

kryerjen e studimeve. Në përfundim të fazave përzgjedhëse, **u kualifikuan si fitues 4 aplikantë dhe u nënshkruan akt-marrëveshjet.**

✚ **Për vitin 2013-2014 janë përfutuar 9(nëntë) projekte TEMPUS** me vlerë 3.8 milionë Euro të cilët po zbatohen nga universitetet shqiptarë ose në partneritet me universitete të tjerë dhe në vitin 2015.

✚ **Programi me shumë përfutues për Tempus nën komponentin e IPA Asistenca për tranzicionin dhe ndërtimin institucional për vitin 2012, nga ky program janë perzgjedhur tre projekte fituese** si me poshte vijon:

- 1) Projekti TEMPUS 2012, kodi projektit 530243 SMHES Developing Third Mission Activities in Albanian Universities me shume totale prej 727,825 Euro
- 2) Projekti Tempus 2012 kodi projektit 530531 JPHEs E-learning, innovation and sustainable Albanian Agriculture me shume totale 503,568 Euro dhe me afat zbatimi 5.10.2012- 14.10.2015
- 3) Projekti Tempus 2012 kodi projektit 530631 JPGR Empowering Universities to fulfil their responsibilities for Quality Assurance me shume totale prej 858,625 Euro dhe me afat zbatimi 15.10.2012-14.10.2015.

Programi me shumë përfutues për TEMPUS nën komponentin e IPA Asistenca për tranzicionin dhe ndërtimin institucional për vitin 2015.

Për vitin 2013, janë shpallur **9 projekte fituese**, të cilët kanë vijuar implementimin dhe në vitin 2015. Ky është numri më i madh i projekteve fituese që Shqipëria ka pasur brenda një viti. Nga këto 9 projekte, përfitojnë gjithsej **44 partnerë shqiptarë nga të cilët 26 Institucione të Arsimit të Lartë** (20 IAL Publike + 6 IAL Private) , 3 ministri dhe 15 institucione të tjera, biznese, agjenci, OJQ, etj

1. Tempus 2013 54327 JPHEs “Connecting Science-Society Collaborations for Sustainability Innovations” me kosto totale prej 968,206 Euro dhe me afat zbatimi 1.12.2013 30.09.2016
2. Tempus 2013 543782 JPCR “Developing and Adapting Professional Programs for Energy Efficiency in the Eastern Balkans” : 543,782 Euro dhe me afat zbatimi 1.12.2013-30.09.2016
3. Tempus 2013 544108 JPHEs Development of higher education and society by creating a collaborative environment in the field of arts and media through regional student partnerships in production of audio/video content me shume totale 827,621 Euro
4. Tempus 2013 544169, JPCR Competency Based Curriculum Reform in Nursing and Caring in Eastern Balkan Universities me shume totale prej 871,139 Euro
5. Tempus 2013 544257, JPCR Modernizing and harmonizing maritime education in Montenegro and Albania me shume totale prej 1,039,301 Euro dhe me afat zbatimi 1.12.2013 30.11.2016
6. Tempus 2013 544302 JPCR Enhancing Albanian system of quality assurance in higher education: Application of the proces and outcomes in higher education: application of the process and outcome-based methodology me shume totale 627.832 Euro dhe afat zbatimi 1.12.2013 30.11.2016
7. Projekti Tempus 2013 JPCR 544362 Sport Professions – Education, Employment, Development in the Balkan Region me shume totale **1,006,985 Euro**
8. Projekti Tempus 2013 544504 JPCR Renewable energy studies in Eastern Balkans me shume totale **1,006,985 Euro** dhe me afat zbatimi 14.02.2014 01.10.2016
9. Projekti Tempus 2013 544595 JPHEs Lifelong learning for sustainable agriculture in Alps-Danube-Adriatic Region me shume totale **1,006,985 Euro** dhe me afat zbatimi 12.12.2013 12.12.2016

Integrimi Evropian, gjatë vitit 2015 janë realizuar;

1. Përgatitja e raportimit për nënkomitetin e përbashkët BE-Shqipëri: Nënkomitetit për “Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë BE – Shqipëri”;
2. Përgatitja e raportimit për Komitetin e Stabilizim Asociimit.
3. Përgatitja e raportimit për nënkomitetin e përbashkët BE-Shqipëri “Për Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën”.
4. Përgatitja e raportimit për Nën-komitetin e “Inovacionit, Shoqëria e Informacionit dhe Politikat Sociale”, Bashkimi Evropian - Shqipëri.
5. Hartimi i progres raportit për kapitujt të cilët i përkasin MAS.
6. Përgatitja e informacionit plotësues për Nën-komitetin “Çështjet Ekonomike, Financiare dhe Statistika”.
7. Rishikimi i Planit Kombëtar të Integritimit Evropian 2015-2020.

8. Hartimi i projekt-strategjisë për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020.
9. Hartimi i indikatorëve në kuadër të Strategjisë për Zhvillim dhe Integrim.
10. Kontribut për Strategjinë për Arsimin parauniversitar 2015-2020.
11. Përgatitja e Deklaratave të PBA 2016-2018.
12. Raportim mujor në kuadër të ROAD MAP Prioriteti 5 “Të drejtat e njeriut”, pjesëmarrjet nëpër mbledhje.
13. Raportim për Planin e Veprimit kundër Korrupsionit 2014-2015.

Bashkëpunimi Ndërkombëtar, gjatë vitit 2015 janë realizuar:

1. Nënshkrimi i marrëveshjeve/ memorandumeve/programeve të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë me vende të ndryshme në fushën e arsimit, shkencës dhe sportit:
2. Janë nënshkruar: Protokolli për bashkëpunim ndërmjet MAS, Gjysmëhënës së Kuqe (EBA) dhe Bashkisë Kavajë, për ndërtimin dhe pajisjen e një kopshti sipas standardeve europiane.
3. Tre 3 (tre) marrëveshje të rëndësishme për bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe shkencës me Kosovën, në Tiranë, më 23 mars 2015:
 - a) Marrëveshja e Bashkëpunimit në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.
 - b) Marrëveshja e Bashkëpunimit për bashkërendim institucional për përparimin dhe zhvillimin profesional të mësimeve në arsimin parauniversitar.
 - c) Marrëveshja e Bashkëpunimit për organizimin e përbashkët të Mësimi të Gjuhës Shqipe dhe të Kulturës Shqiptare në Diasporë dhe në Mërgatë.
4. Në datë 8 qershor 2015 “Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Universitetit Teknik të Stambollit”, për praninë për studime dhe mbështetje studentësh/maturantësh të shkëlqyer.
5. Në datë 2 Korrik 2015, në Vlorë “Marrëveshja me Maqedoninë për bashkëpunim në fushën e arsimit dhe shkencës”. Miratuar në parim me VKM nr. 570, datë 24.06.2015 Miratuar VKM nr. 781, datë 22.09.2015
6. Në datë 2 Korrik 2015 në Vlorë “Marrëveshja ndërmjet qeverisë së Republikës së Serbisë dhe të shteteve të tjera, për Selinë e Sekretariatit të Nismës së Evropës Juglindore për Reformën në Arsim (Education Reform Initiative of South Eastern Europe-ERI SEE)”. Miratuar në parim me VKM nr. 586, datë 10.06.2014, Miratuar me VKM nr. 782, datë 22.09.2015
7. Në datën 29 Korrik 2015 në Vjenë “Marrëveshja për Programin e Shkëmbimit të Studimeve Universitare në Evropën Qendrore, CEEPUS III (Central European Exchange Program of University Studies)”.
8. Në datën 18 Shtator 2015 në Kroaci, “Marrëveshja mbi Qendrën e Kërkimit Shkencor të Ballkanit Perëndimor dhe Inovacionit – ĒISE”, Miratuar me VKM nr. 785, datë 22.09.2015
9. Në datën 13 Tetor 2015 në Pragë, “Marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit, rinisë dhe sporteve të Republikës së Çekisë për bashkëpunimin në fushën e arsimit për vitet 2015-2018”.
10. Në datë 20 Nëntor 2015 në Tiranë “Memorandumi i Mirëkuptimit për bashkëpunim në fushën e arsimit të lartë ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Arsimit të Lartë të Republikës së Turqisë” (YOK).
11. Më 22 nëntor 2015 në Manastir, Maqedoni “Programi i bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë për periudhën 2015-2018”.
12. Në datë 21 Dhjetor 2015 “Memorandumi i Bashkëpunimit mes Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Yad Vashem, Autoriteti i Përkujtimit të Martirëve dhe Heronjve të Holokaustit”, për të bashkëpunuar në promovimin e edukimit dhe përkujtimit të Holokaustit.

Raportim për SEE 2020 dhe në kuadër të ERI SEE për nëndimensionin e arsimit dhe kërkimit shkencor dhe inovacionit. Raportim në kuadër të NERP 2015 (National Economic Reform Programme).

Hartim projektakesh

1. “Marrëveshje e bashkëpunimit ndërmjet Republikës Portugeze dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë në fushat e gjuhës, arsimit, kulturës, sportit, rinisë dhe mjeteve të komunikimit”. Miratuar në parim me VKM nr.705, datë 26.08.2015
2. Protokolli ndryshues i “Marrëveshjes së bashkëpunimit shkencor dhe teknik midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Argjentinës nënshkruar në Tiranë më 19 korrik 2007”.

Vizita/Takime Zyrtare

1. Vizita e studentëve kinezë nga Universiteti i Financës dhe Ekonomisë së Tianjin-it (TUFE) në Shqipëri; 6-13 Shkurt 2015,
2. Organizimi i një vizite 3-ditore në jug të Shqipërisë, të një grupi mësuesish dhe nxënësish nga Lugina e Preshevës. 25-27 Qershor 2015 në Vlorë,
3. “Takimi i katërt të Platformës së Ballkanit Perëndimor për Arsim dhe Trajnim”; 2-3 Korrik 2015 në Vlorë
4. 7-9 Tetor 2015 vizita e studentëve serbë me rastin e ndeshjes së futbollit Shqipëri-Serbi në 8 tetor 2015.
5. Realizimi i takimeve të Znj. Lindita Nikolla, Ministër i Arsimit dhe Sportit me ministra homologë, Ambasadorë, etj. Përgatitje informacioni mbi bashkëpunimin e MAS me shtete të ndryshme për titullarët e MAS dhe MPJ.

Mobiliteti i studentëve dhe stafit akademik

1. Janë realizuar bursat dhe të drejtat e studimit në nivel universitar dhe pasuniversitar në kuadër të bashkëpunimit dy- dhe shumëpalësh arsimor dhe shkencor, si dhe të programeve të mobilitetit sipas marrëveshjeve me Francën, Çekinë (4 bursa master), Sllovakinë (4 bursa universitare dhe 1 pasuniversitare), Hungarinë (20 bursa studimi), Poloninë (12 të drejta studimi), Rusinë (37 bursa universitare/pasuniversitare), Rumaninë, Bullgarinë (3 bursa vere), Egjiptin (5 bursa universitare dhe 4 bursa pasuniversitare), Turqinë, Greqinë, Italinë (54 muaj bursa universitare), Egjiptin (5 bursa universitare dhe 4 bursa pasuniversitare), Kinën (3 bursa për studime universitare/pasuniversitare, Japoninë (1 bursë pasuniversitare), EBA (10 bursa master/Phd për energjinë e ripërtëritshme), VISEGRAD, CEEPUS.
2. Realizimi i kursit të verës të gjuhës shqipe me pjesëmarrjen e 45 shtetasve të huaj, 1-30 shtator 2015. Urdhër nr. 266, datë 08.07.2015 (hapja e kursit të verës)
3. Hartimi i udhëzimeve të Ministrit për pranimin e shtetasve të huaj për studime në ciklin e parë dhe të dytë në IAL shqiptare, ndjekja e procedurave për regjistrimin e shtetasve të huaj në IAL shqiptare (6 shtetas të huaj). Udhëzimi nr.32 datë 02.09.2015 (procedura e pranimit të shtetasve të huaj në ciklin e parë të studimeve) Udhëzimi nr.51 datë 1.12.2015 (procedura e pranimit të shtetasve të huaj në ciklin e dytë të studimeve)
4. Mbikëqyrja dhe vijimi i projektit pilot për mësimdhënien e gjuhës kineze në arsimin parauniversitar. Aktualisht janë 2 mësues kinezë për mësimdhënien e gjuhës kineze në 4 shkolla. Urdhër nr. 404, datë 27.10.2015 (regjistrimi i shtetasve të huaj në kursin 1 vjeçar të gjuhës shqipe dhe trajtimi me bursë).
5. Raporti për Komisionin Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI).
6. Pyetësori i dytë, “Dekada e Kombeve të Bashkuar për edukimin e qëndrueshëm” (CESCR).
7. Raport për Komitetin për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAË).
8. Kontribut i MAS për Kartën Evropiane të Gjuhëve Rajonale.
9. Raporti kombëtar i ciklit të dytë të Mekanizmit të Rishikimit Periodik Universal (UPR).
10. Raporti fillestar mbi zbatimin e Konventës "Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara" (PAK).
11. Kontribut për Rezolutën 68/176 të OKB-së, në fushën e të drejtave të njeriut në kurrikulën zyrtare të arsimit para-universitar.
12. Raportim për “Planin e Veprimit Kombëtar për Aleancën e Qytetërimeve” (UNAOC).
13. Raporti kombëtar në kuadër të Konventës së OKB-së “Kundër eliminimit të të gjitha formave të diskriminimit racia” (CERD).
14. Raportim në kuadër të Sesionit të 29 të Këshillit të të Drejtave të Njeriut (KDNJ).
15. Raporti kombëtar për "Për mbrojtjen e të drejtave të punonjësve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre (CMË).

16. Raporti kombëtar për zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për mbrojtjen e pakicave".
17. Raportim mbi zbatimin e angazhimeve të dimensionit njerëzor (HDIM) të ODIHR/OSBE mbi "Edukimi për/me të drejtat e njeriut"
18. Hartimi i raportit të Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit për vendin.

Rritja e pjesëmarrjes në programet e BE-së (IPA, ĒBIF Single Sector Project Pipeline).

Gjatë vitit 2015 është aplikuar për 4 projekte TAIEX:

1. "Asistencë për përafrimin e kapitullit 25";
 2. "Asistencë për përafrimin e kuadrit të profesioneve të rregulluara me Direktivën 36/2013 të BE";
 3. "Mosdiskrimini dhe gjithëpërfshirja në Arsim";
 4. "Asistencë për përafrimin e legjislacionit në kuadër të kapitullit 26".
- Organizimi i një trajnimit në kuadër të TAIEX me temë: "Mosdiskriminimi dhe gjithëpërfshirja në Arsim" në tetor 2015.

Single Sector Project Pipeline

1. Bazuar në kërkesën për projekte nga Njësia e Planifikimit Strategjik & Zhvillimit (NjPSZh) në KM janë përcjellë kërkesat për projekte dhe informacioni përkatës pranë përfituesve.
2. Janë dorëzuar 13 projekt fisha në KM

✚ Sfidë kryesore në fushën e kërkimit shkencor mbetet rritja e investimit privat në shkencë.

Fondet për vitin 2015 në këtë program u miratuan në total në vlerën **177 milion lekë, buxheti i rishikuar për vitin 2015 arriti në masën 183.3 milion lekë, së bashku me të ardhurat e realizuara nga IAL publike si dhe projektet donatore arriti në 315.2 milion lekë. Realizimi i fondeve për 12-mujorin 2015 në këtë program është 299.8 milion lekë ose 95% dhe përfaqëson rreth 0.7 % të shpenzimeve të realizuara për 12- mujorin e vitit 2015 të fondeve buxhetit të MAS, krahasuar me shpenzimet publike fondet për arsimin për vitin 2015 arrijnë në **0.07%** dhe ndaj produktit të brendshëm bruto për vitin 2015 janë në nivelin **0.02%**.**

Sipas zërave kryesore, krahasuar me planin vjetor rezulton si më poshtë:

Shpenzime korente	95 %
Shpenzime kapitale	100 %

Totali 95 %

Në këtë program janë parashikuar për t'u realizuar produktet e mëposhtem, ecuria e të cileve krahasuar me planin vjetor jepet në tabelë:

Kodi i Produktit	Emri i Produktit	Buxheti Plan 2015	Buxheti i Rishikuar 2015	Fakti 12-mujor 2015	Realiz 12-mujor në % 2015
A	Mbeshtetje financiare për Programe Kërkimore në IAL dhe kërkesat të rinj të mbështetura financiarisht.	6,000	6,000	5,192	87%
B	Financimi i Programe Nderkombetare të Bashkëpunimit Shkencor e Teknologjik të mbështetura financiarisht.	6,400	6,400	likujduara nga të ardhurat	
C	Financimi i Projekte të Rëndësishme të vecanta të mbështetura financiarisht nga MAS.	6,400	6,400	likujduara nga të ardhurat	
D	Pjesëmarrja në programin Horizon 2020, program për Kërkimin dhe Inovacionin (2014 - 2020).	40,800	40,800	40,800	100%
E	Promovimi dhe financimi i projekteve në kuadrin e Programeve Kombëtare dhe Nderkombetare të Kërkimit dhe Zhvillimit, nëpërmjet Konferencave dhe Seminareve të organizuara nga MAS.	2,400	2,400	2,400	100%
F	Kërkesat dhe shkencëtarë të rinj që kryejnë studimet e tyre Universitare & studime doktorature në 15 universitet me të mira të botes, si programi BRAIN GAIN	115,000	115,000	113,312	99%
	TOTALI	177,000	177,000	161,704	91%
	Shpenzime jashtë buxhetore		131,888	131,888	100%
		177,000	308,888	293,592	95%

VII – Programi për Zhvillimin e Sportit . (Titulli buxhetor i programit 08140)

Synimet e programit për Zhvillimin e Sportit janë; Sigurimi dhe mbrojtja e të drejtave të shtetasve, që merren me edukim fizik dhe sport, në përputhje me Kartën Evropiane të Sportit dhe me rekomandimet e organizatave ndërkombëtare në këtë fushë. zbatimin dhe përmirësimin e politikave shtetërore për sportin Elitar dhe sportin në institucionet arsimore në drejtimin organizativ, teknik dhe funksional, qëndror dhe lokal. Krijimin e shanseve të barabarta dhe kushteve për pjesëmarrjen në aktivitete sportive të të gjithë shtetasve shqiptar mbështetur në të drejtat e njeriut për të ushtruar aktivitet fizik e sportiv, duke krijuar infrastrukturën e duhur ligjore, financiare dhe fizike, rregullimin e mardhenieve shtet-institucione sportive. Siguron shërbim cilësor në sistemin Arsimor parauniversitar dhe atë universitar, duke qënë se sporti është pjesë përbërëse e programit të edukimit të nxënësve dhe studentëve në institucionet arsimore publike dhe jopublike.

Fondet për vitin 2015 në këtë program u miratuan në total në vlerën **502.8 milion lekë, buxheti i rishikuar për vitin 2015 arriti në masën 1 miliard e 844 milion lekë, së bashku me të ardhurat e realizuara arriti në 1 miliard e 845.6 milion lekë, realizimi i shpenzimeve për 12-mujorin 2015 në këtë program është 1 miliard e 717.6 milion lekë ose 93% dhe përfaqëson rreth 4.4 % të shpenzimeve të realizuara për 12- mujorin e vitit 2015 të fondeve buxhetit të MAS, krahasuar me shpenzimet publike fondet për arsimin për vitin 2015 arrijnë në **0.38%** dhe ndaj produktit të brendshëm bruto për vitin 2015 janë në nivelin **0.12%**.**

Objektivat e planifikuara për vitin 2015

- 1) Rishikimi i ligjit për sportin, në sistemin sportiv kombëtar në përputhje me standardet ndërkombëtare, me synim respektimin e pavarësisë së tyre funksionale si organizata jofitimprurëse .
- 2) Mbështetja e Federatave Olimpikë me synim pjesëmarrjen në aktivitete kualifikuese për Lojërat Olimpikë Rio 2016.
- 3) Rritja e mbështetjes financiare për aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare për Federatat Sportive për të gjitha disiplinat sportive, sipas kalendarëve të aktiviteteve në 38 Kampionate Kombëtare dhe 38 Kupa Shqipërisë, 38 Kampionate Evropiane , si dhe 38 Kampionate Botërore
- 4) Mbështetja e Agjencisë së Shërbimit të Sportit në përmirësimin e infrastrukturës së objekteve që ajo ka në administrim
- 5) Rishikimi i Statusit dhe rritja e mbështetjes financiare të sportistëve elitare, duke përcaktuar standardet e arritjeve/ titujve/rekordeve dhe medaljeve si dhe masën e shpërblimit të sportistëve që do të arrijnë rezultate në aktivitetet ndërkombëtare
- 6) Krijimi i shoqatave të Sportit në shkolle

Realizimet sipas objektivave të parashikuara

Objektivi 1.1 Ka përfunduar, ndryshimet mbi ligjin e sportit, ku thelbin kryesor e kanë

1. Rritjen e autonomisë dhe krijimin e mundësive për vetë menaxhim të organizatave sportive kombëtare dhe lokale, nëpërmjet përcaktimit të kompetencave të pushteteve dhe lëvizjes sportive (federata, shoqata dhe klube) me synim rritjen dhe forcimin e demokracisë së brendshme, të organizatave sportive, ndërgjegjësimin dhe disiplinimin në përdorimin e fondeve që ato përfitojnë nga buxheti i shtetit dhe nga të ardhurat dytësore, në respektim të kriterëve të përcaktuara për sportin.
2. Përfshirjen për herë të parë të edukimit fizik dhe sportit shkollor në një kapitulli të veçantë, si dhe përcaktimin e kufirit minimal të ngarkesës mësimore të lëndës së edukimit fizik në kurrikulën bërthamë, organizimin e federatave të sportit shkollor dhe universitar, në funksion të institucionalizimit dhe organizimit të veprimtarisë sportive në institucionet arsimore.
3. Për të parën herë në historinë e sportit shqiptar, një sportist elitare personifikohet me “Status”, i cili përmban në vetvete program zhvillimi, përcaktim kriterëve për mbështetjen financiare dhe shpërblim për arritje.
4. Fuqizimin e kompetencave të Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv (KAS), si një faktor për sigurimin e stabilitetit të marrëdhënieve midis organizatave sportive.

5. Përcaktimin e statusit juridik të klubeve sportive, i cili do t'i japë status ligjor klubeve sportive aktuale, si dhe përfshirjen e llojit të klubeve “shumë sportesh”, pasi në ligjin aktual mungon.
6. Është përcaktuar pavarësia e Komisioni Kombëtar Antidoping, si një strukturë e pavarur pranë Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar. dhe krijimi i tij do te kryhet me Vendim te Këshillit te Ministrave

Objektivi 2.2 Është realizuar ndarja e fondit grand për federatat, ne funksion dhe ne zbatim të Udhëzimi e Përbashkët nr.4 datë 11.-3.2014 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrit të Financave “Për mënyrën e përdorimit te fondit grand/ transfertë korrente e brendshme për federatat dhe Komitetin Olimpik shqiptar”. Janë mbështetur për vitin 2015 janë Federata Sportive dhe Komiteti Olimpik Kombëtar

1. **Federata Shqiptare e Atletikes me shumën 9,500,000 leke** ka realizuar 12 aktivitete kombëtare për te gjitha kategoritë e moshave , 17 aktivitete ndërkombëtare ku spikasin aktivitetet kualifikuese për Lojërat Olimpike , pjesëmarrja e sportistëve ne Lojërat Evropiane Baku 2015. dhe 6 aktivitete për fëmijë .Federata e Atletikes gjate viti 2015 ka marre 4 medalje (**2 ari dhe 2 argjendi**) ne Kampionatet Ballkanike dhe Evropiane .
2. **Federata Shqiptare e Basketbollit me shumën 11,000,000 leke** ka realizuar 22 aktivitete kombëtare për të gjitha kategoritë e moshave, 6 aktivitete ndërkombëtare. Federata e Basketbollit ka nje vit qe implementim projektin Basketbolli neper shkolla (marrëveshje MAS-FSHB)
3. **Federata Shqiptare e Volejbollit me shumën 11,000,000 leke** ka realizuar 16 aktivitete kombëtare për te gjitha kategoritë e moshave , 4 aktivitete ndërkombëtare ku spikasin moshat (te rinjtë para te rinjtë te reja para te reja).
4. **Federata Shqiptare e Peshëngritjes me shumën 9,500,000 leke** ka realizuar 5 aktivitete kombëtare për te gjitha kategoritë , 4 aktivitete ndërkombëtare ku spikat Kampionati Botëror ne USA ku sportisti ynë Briken Calja zuri vendin e 8 ne bote. Sportisti Erkand Qerimaj eshte afër normës se kualifikimit per ne lojrat Olimpike (vendimtare kampionati Evropian ne vitin 2016)
5. **Federata Shqiptare e Mundjes me shumën 8,500,000 leke** ka realizuar 7 aktivitete kombëtare për te gjitha kategoritë e moshave, 5 aktivitete ndërkombëtare (evropiane dhe Botërore për te dy disiplinat) kualifikuese për Lojërat e Olimpikes. Federata e Mundjes për vitin 2015 ka marre 3 medalje bronzi ne kampionatin Ballkanik për kadet, dhe realizuar 2 aktivitete sportive shkollore.
6. **Federata Shqiptare e Boksit me shumën 9,000,000 leke** ka realizuar 5 aktivitete kombëtare për te gjitha kategoritë e moshave, 7 aktivitete ndërkombëtare ku spikasin aktivitete kualifikuese për Lojërat Olimpike Rio 2016. Gjate vitit 2015 federata Shqiptare e Boksit ka marre 2 ari dhe 3 argjendi ne Turne ndërkombëtar , dhe kupën e boksierit me te mire (Rexhildo Zeneli)
7. **Federata Shqiptare e Ciklizmit me shumën 9,500,000 leke** ka realizuar 8 aktivitete kombëtare për të gjithë grup moshat, 7 aktivitete ndërkombëtar të gjitha kualifikues për Lojërat Olimpike Rio 2016. Federata Shqiptare e Ciklizmit pretendon qe me aktivitetet ndërkombëtare për vitin 2016 të kualifikoje 1 sportist për lojërat Olimpike.
8. **Federata Shqiptare e Judo-s me shumën 3,000,000 leke** ka realizuar 5 aktivitete kombëtare për te gjithë kategoritë e moshave , 12 aktivitete ndërkombëtare kualifikuese për lojërat Olimpike Rio 2016 , pretendohet për 1 sportit për tu kualifikuar për ne Olimpiadë .
9. **Federata Shqiptare e Notit me shumën 2,500,000 leke** ka realizuar 8 aktivitete kombëtare për te gjithë grup moshat , 7 aktivitete ndërkombëtare ku spikat Kampionati Botëror Rusi kualifikues për lojërat Olimpike . Federata Shqiptare e Notit ka te kualifikuar 1 (mashkull) sportist për ne Lojërat Olimpike dhe pritet qe ne aktivitetet ndërkombëtare te vitit 2016 te kualifikoje dhe 2 sportistë (mashkull - femër) për ne Olimpiadë.
10. **Federata Shqiptare e Qitjes me shumën 3,500,000 leke** ka realizuar 11 aktivitete kombëtare nga këto 2 aktivitete për qitjen me pjatel, 6 aktivitete ndërkombëtare kualifikuese për lojërat Olimpike, ku pretendohet qe te kualifikohet, 1 sportist.
11. **Federata Shqiptare e Taekëondo E me shumën 1,500,000 leke** ka realizuar 3 aktivitete kombëtare për të gjithë kategoritë e moshave, 2 aktivitete ndërkombëtare kualifikuese për Lojërat Olimpike Rio 2016. Pretendohet qe të kualifikohet 1 sportiste femër.
12. **Federata Shqiptare e Ping-pongut me shumën 2,500,000 leke** ka realizuar 8 aktivitete kombëtare për te gjitha kategoritë e moshave , 10 aktivitete ndërkombëtare ku spikat Kampionati Ballkanik për te rinje dhe te reja ku ekipi ynë mori **medaljen e Bronzit** , një aktivitet kombëtar për shkollat 9 vjeçare .
13. **Federata Shqiptarë e Tenisit me shumën 500,000 leke** ka realizuar 2 aktivitete kombëtare, Kampionati Kombëtar dhe Kupa e Republikës.

14. **Federata Shqiptare e Shahut me shumen 3,000,000 leke** ka realizuar 6 aktivitete kombëtare për te gjitha grup moshat , 3 ndërkombëtare ku spikat Evropiani dhe Botërori për moshat 8-18 vjeç , ku spikat vendi i 7-e ne Botëror moshë 10 vjeç dhe Kampionatin Mesdhetar U-20 (**1 ari dhe 1 bronzi**)
15. **Federata Shqiptare e Alpinizmit ne shumen 2,000,000 leke** ka realizuar 2 aktivitete kombëtare ku spikat ngjitja ne Nemërçke, 2 aktivitete ndërkombëtare , ku spikat ngjitja ne Matka , Maqedonisë
16. **Federata Shqiptare e Gjymnastikës ne shumen 2,000,000 leke** ka realizuar 8 aktivitete kombëtare ne te gjitha kategoritë e moshave , 7 ndërkombëtare ku spikat turneu ndërkombëtar i Sllovenisë ku sportistja jone **Ornela Reci vendin e 3-te**
17. **Federata Shqiptare e Karatesë ne shumen 3,000,000 leke** ka realizuar 4 aktivitete kombëtare për te gjitha kategoritë e grup moshave , 6 aktivitete ndërkombëtare ku spikat Kampionati ballkanik për fëmijë (**3 medalje bronzi**)
18. **Federata Shqiptare e Dancit Sportiv ne shumen 1,500,000 leke** ka realizuar 16 aktivitete kombëtare sipas disiplinave , 48 ndërkombëtare sipas disiplinave ku spikat aktiviteti ndërkombëtar zhvilluar ne Tirane, “Tirana Eorl Open” ku ekipi ynë mori **1 ari , 5 argjendi dhe 3 bronzi**

- Gjatë vitit 2015 është mbështetur Komiteti Olimpik Special për Kampionatin Botëror për persona me aftësi të kufizuar zhvilluar në USA.
- Është realizuar mbështetja financiare për pjesëmarrjen e Shqipërisë ne Lojërat e Para Olimpike Evropiane Baku 2015 (ku u morën **3 medalje 1 ari dhe 2 argjendi**)

Objektivi 3.3 Janë realizuar mbi 20 aktivitete kualifikuese ndërkombëtare, numri më i lartë i këtyre aktiviteteve për Federatave Olimpike. Rezultati i këtyre aktiviteteve është kualifikimi i 2 sportistëve për përfaqësimin e Shqipërisë në lojërat Olimpike, ne sportet Atletike dhe Not. Për këto dy disiplina kemi dhe dy kandidatura qe janë shume afër kualifikimit në atletik dhe not, gjithashtu pretendimet vazhdojnë ne sportet e peshëngritjes, mundjes , judos , taekwondo ëord, Qitje dhe çiklizmit ktivitete kualifikuese vazhdojnë akoma dhe ne vitin 2016 deri dy muaj përpara Lojërave Olimpike Rio 2016.

Objektivi 4.4. Rikonstruksioni i Stadiumit të Shkodrës e cila kap shifrën **1.5 miliard lekësh**. Ndërtimi i Qendrës kombëtare sportive Tirana Olimpik park pranë ish kompleksit Dinamo e cila kap **shifre 600 milion lekë**.

Gjithashtu është siguruar partneritet me organizata të vendit e të huaja për të mundësuar përmirësimin e infrastrukturës dhe bazës materiale sportive në institucionet arsimore, në funksion të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, si: Fondacioni Hollandez “Sport for children”, Federata Shqiptare e Futbollit, Federata Evropiane e Volejbollit, etj.

Objektivi 5.5. Krijimi i shoqatave të sportit në shkollë. Në kuadër të krijimi i Federatës së Sportit Shkollor gjatë vitit 2015 u realizua faza e parë e organizimit të sportit në nivel shkollor, krijimi i Shoqatave të Sportit Shkollor. Qëllimi i tyre është promovimi, zhvillimi dhe realizimi i veprimtarive sportive gjithvjetore në shkollë, me përfshirjen dhe organizimin e nxënësve të shkollës, si dhe përfaqësimin e shkollës në veprimtaritë sportive ndërkollore jashtë procesit mësimor. Këto shoqata janë krijuar pothuajse në të gjitha shkollat e sistemit parauniversitar në vend dhe po kryejnë aktivitetin e tyre.

Krijimi i shoqatave rajonale Është përgatitur dokumentacioni i nevojshëm për krijimin dhe regjistrimin e Shoqatave Rajonale të Sportit Shkollor, si faza e dytë e projektit për krijimin e Federatës së Sportit Shkollor.

Anëtarësimi në Federatën ndërkombëtare të Sportit Shkollor. Në Nëntor të vitit 2015, Shqipëria u pranua anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Sportit Shkollor me përfaqësuese të saj Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Si rrjedhojë e këtij anëtarësimi, Shqipëria ka fituar të drejtën e pjesëmarrjes në të gjitha aktivitete ndërkombëtare të sportit shkollor, me ekipe e sportistë përfaqësues të shkollave Shqiptare.

Projekte për promovimin e sportit në shkollë. Janë nënshkruar dy marrveshje me Federatën Evropiane të Shahut (dhe Federatën Shqiptare të Shahut) dhe me Federatën e Xhudos, për impementimin e programeve mësimore “Mësime të shahut në shkollë” dhe “Mësime të xhudos në shkollë”.

Projekti i shahut. Projekti i shahut konsiston në mundësimin e marrjes së leksioneve dhe njohurive mësimore për shahun nga nxënësit e shkollave, nëpërmjet aktiviteteve ekstrakurrikulare në laboratorë e teknologjisë së informacionit të shkollave, me anë të regjistrimit dhe anëtarësimit me dëshirë të nxënësve, on line në Fide dhe Fshsh, në linkun: <http://sm.fide.com/> dhe <http://psm.fide.com/>, si dhe zhvillimin e orëve mësimore ekstrakurrikulare, në formën e praktikave zbavitëse, si dhe garave sportive të organizuara. **Ministria** ofrojnë dhe mundësojnë bashkëpunimin e saj, nëpërmjet të gjitha Drejtorive Arsimore Rajonale në territorin e Shqipërisë, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për të implementuar projektin “ Mësimet e Shahut në Shkollë ”, si dhe do të mundësojnë promovimin e anëtarësimit të nxënësve të shkollave në Fide nëpërmjet paketa: [sm](#) dhe [psm](#), në të gjitha shkollat e vendit, nëpërmjet DAR dhe ZA.

Projekti i xhudos, Projekti i xhudos konsiston në implementimin e një programi, që do të përmbajë leksione dhe orë mësimore për t'u njohur me sportin e judos dhe fillimin e tij si një praktikë zbavitëse dhe jetësore, në përputhje të plotë me zhvillimin fizik e mendor të moshave përkatëse. Implementimi i këtij projekti është falas për komunitetin. Për hir të qartësisë, kjo do të thotë se trajnerët dhe instruktorët e Federatës që janë të anagazhuar në projektin Judo për Fëmijë do të japin leksione falas për komunitetin në shkollat – qendra komunitare. Gjithashtu baza materiale – tatami, dyshekë speciale - do të ofrohet nga Federata pa pagesë. Projekti i Judo për Fëmijë është mbështetur nga Federata Ndërkombëtare e Judo-s (IJF).

Projekti me fondacionin “Sport for children”, në bashkëpunim me fondacionin holandez “Sport for children”, u realizua faza e dyte e projektit për paisje me bazë materiale sportive didaktike të shkollave 9-vjeçare të qytetit të Tiranës. Shkollat që përfituan nga prurja e dytë janë: “Ibrahim Brahja”, “Qazim Turdiu”, Musine Kokalari” dhe Ahmet Gashi”.

Projekti me Federatën e Volejbollit, në bashkëpunim me Federatën e Volejbollit, në vitin 2014 u aplikua pranë Konfederatës Europiane të Volejbollit, për mbështetjen e projektit “**Top Mini Volleyball**”, i cili po atë vit u miratua. Projekti konsiston në promovimin e sportit të volejbollit në shkollat 9-vjeçare në rank vendi dhe paisja e tyre me bazën materiale të nevojshëm për zhvillimin e këtij sporti. Faza e parë e projektit (shpërndarja e bazës materiale) ka filluar, në disa shkolla në vend.

Aktivitete të tjera, po në kuadër të promovimit të sportit shkollor, në bashkëpunim me federata ndërkombëtare, në bashkëpunim me Federatën Ndërkombëtare të Orienteringut, është organizuar trajnim i mësuesve të edukimit fizik në qytetet e Tiranës dhe Shkodrës, si dhe veprimtari të tjera si simultane shahu, kampionati i dytë kombëtar për shkollat 9-vjeçare, në bashkëpunim me Federatën e Futbollit, kampionatet në shkolla në shah dhe mundje.

Programi	Programi Per Zhvillimin e Sportit				Realizimi % I buxhetit per vitin 2015
Kodi i		Buxheti	Buxheti Vjetor	Fakti 12-mujor	
Produktit	Emri i Produktit	Plan 2015	Rishikuar 2015	2015	
A	Rishikimi i formës së financimit në sistemin sportiv kombëtar në përputhje me Ligjin e Sportit,	47,769.0	5,000.0	3,952.3	79%
B	Mbështetja financiare me investime për rristurimin/ ndërtimin dhe pajisjen e objekteve sportive pranë Agjencisë së Shërbimit të Sportit në funksion të përmirësimit të kushteve, për nxitjen rritjen e numrit të ushtruesve në sport	328,000.0	1,650,002.0	1,543,275.2	94%
C	Mbështetja financiare e programeve për kërkimin shkencor dhe kualifikimin shkencor në sport, Mbështetja e programeve trainuese në sistemin sportiv kombëtar në funksion të rritjes së kapaciteteve në fushën e sporti	10,000.0	15,000.0	15,000.0	100%
D	Mbështetja financiare e aktiviteteve të ekipeve sportive perfaqesues të shkollave ne disiplina te ndryshme , me synim hedhjen e baze per krijimin e shoqatave Sportive shkollore	20,000.0	2,400.0	2,400.0	100%
E	Krijimi i kushteve per funksionimin e Klubeve Sportive, (Klubi studenti, Klubi Partizani, KOSH)	42,000.0	37,909.6	33,293.7	88%
F	Statusit dhe rritja e mbështetjes financiare të sportistëve elitare, duke përcaktuar standardet e arritjeve/ titujve/rekordeve dhe medaljeve si dhe masën e shpërblyerjes të sportistëve që do të arrijnë rezultate në aktivitetet ndërkombëtare	15,000.0	15,000.0	15,000.0	100%

G	Rritja e mbështetjes financiare për aktivitetet kombëtare dhe ndërkombetare, për të gjitha federatat sportive për vitin 2015	40,000.0	118,706	117,162	99%
	TOTALI	502,769.0	1,844,017.4	1,716,083.5	93%
	Shpenzime jashtë buxhetore	0	1,541	1,541	100%
		502,769	1,845,559	1,717,625	93%

Të dhëna për Aktivitetet Nderkombetare e Federatave Shqiptare Sportive të zhvilluara për vitin 2015

Federata			femra				mesh kuj				U 21	te rinje te reja			TOTALI
Shqiptare	Ba llk.	Euro p	Boteror	Kualifi kuere LO	L O	Ba llk	Euro p	Bote ror	Kualif ikuere LO	L O	Ball k.	Euro p	Boteror	Te tjera	Aktiviteteteve
Noti	1	1	1	3	1	1	1	1	3	1	1	1	1	1	18
Ping/pong	1	2	1	1		1	1	1	1		2	1			11
Atletik	5	4	2		1	5	4	2			3		1	4	31
Judo	1	2		3		1	2		3		3	3		2	20
Mundje									5			2	2	2	11
Qitje		1					1								2
Çiklizmi						1	1	1						4	7
Boksi									2			1		4	7
Tenis														1	1
Karate		1	1				1	1			3	2			9
Bilardo		2					2					2			6
Taekëondo	1	1			1	1	1			1		1	1	5	13
Shah		1	1				1	1				2		1	7

Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit për 12- mujin 2015;

1. Nuk janë realizuar në kohë punimet sipas detyrimeve kontraktore dhe sipas grafikut të punimeve dhe detyrimeve kontraktore nga firma zbatuese e punimeve për Ndërtimin e Parkut Olimpik të Tiranës.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin

PLARENT NDRECA

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM